EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5919
E premte, 1 nëntor 2019
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Pacolli, ministrave të jashtëm: Njohja e Kosovës, kontribut për paqen në rajon

FAQE 3



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KRYETARI I NISMËS SOCIALDEMOKRATE, FATMIR LIMAJ, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA FAQE 4-5

# Limaj: Papërgjegjshmëria e KQZ-së ka rrënuar procesin dhe integritetin zgjedhor



Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vlerësuar se procesin zgjedhor të 6 tetorit e kanë përcjellë keqadministrimi, papërgjegjësia dhe standardet e dyfishta. Në një konferencë për media ai ka thënë të enjten se KQZ-ja i ka ikur përgjegjësisë kushtetuese për administrimin e zgjedhjeve duke mos marrë vendime që ia përcakton ligji. Limaj ka theksuar se ikja e vazhdueshme e KQZ-së nga vendimmarrja ka rrënuar integritetin e zgjedhjeve dhe ka shkaktuar pasoja gati të pariparueshme. Sipas tij, papërgjegjshmëria e KQZ-së ka rrënuar procesin dhe integritetin zgjedhor. Limaj ka thënë se edhe vendimet e Gjykatës Supreme janë pasojë e sjelljes kaotike e të papërgjegjshme të KQZ-së

## Grupet punuese të LV-së dhe të LDK-së diskutojnë për sigurinë dhe drejtësinë



Grupet punuese të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë takuar sërish të enjten, me ç'rast kanë diskutuar për sigurinë e jashtme dhe të brendshme, për procesin e vetingut, për ligjin për shqyrtimin dhe verifikimin e pasurisë së pajustifikueshme, për trajtimin e krimeve të luftës dhe për krijimin e mekanizmave shtetërorë për dokumentimin dhe arkivimin e krimeve të luftës në Kosovë, si dhe për krijimin e një organi të posaçëm për hetime me qëllim të dekriminalizimit të institucioneve shtetërore FAQE 3



## Në Bruksel nënshkruhet marrëveshja për zbatim të planit të përbashkët të veprimit kundër terrorizmit

FAQE 7

## OPINION

### DËNIMI I SERBISË PËR GJENOCID I HAPË RRUGË PAQES SË QËNDRUESHME NË EVROPËN JUGLINDORE F. 12

Shkruan: Jakup KRASNIQI



## AKTUALE

### KQZ-JA ZBATON VENDIMIN E SUPREMES PËR NUMËRIMIN E MBI 4 000 VOTAVE TË DIASPORËS F. 5

### POLICIA REALIZON AKSION NË 46 LOKALE TË NDRYSHME, MBYLL 10 PREJ TYRE F. 7

### THAÇI KËRKON NGA SENATORJA FRANCEZE PËRKRAHJE KONKRETE NGA SHTETET ANËTARE TË BE-së F. 7



## EKONOMI

### BQK-JA SHËNON DITËN BOTËRORE TË KURSIMEVE F. 9

## SPORT

### DRENICA E MOTIVUAR KËRKON PIKË EDHE NDAJ LLAPIT F. 18

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Reeker: ShBA-ja nuk është e përqendruar në çështjen e kufijve

**Ndihmëssekretari amerikan i Shtetit Philip Reeker ka thënë se Shtetet e Bashkuara nuk janë të përqendruara në ndryshimin e kufijve midis Kosovës dhe Serbisë, por në atë që të dyja vendet të gjejnë rrugë përpara dhe të paracaktojnë ide për gjetjen e zgjidhjes**



PRISHTINË, 31 TETOR - Shtetet e Bashkuara nuk janë të përqendruara në idenë e ndryshimit të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë. Kështu ka thënë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ushtruesi i detyrës së ndihmëssekretarit amerikan të Shtetit për çështje të Evropës dhe Euroazisë, Philip Reeker.
Sipas tij, Shtetet e Bashkuara duan që Kosova dhe Serbia të gjejnë një rrugë përpara, që "do të sillte mundësi më të mira për njerëzit në Serbi, për njerëzit në Kosovë dhe për të gjithë rajonin". "Nëse nuk ka marrëveshje, nuk lëvizni përpara", ka paralajmëruar Reeker.
Sa i përket angazhimit të diplomatëve Mathhew Palmer dhe Richard Grenell në dialogun Kosovë-Serbi, Reeker ka thënë se ne kemi mbështetur dialogun Kosovë-Serbi nga fillimi.
"I kemi mbështetur përpjekjet e Bashkimit Evropian. Kemi tentuar të jemi partnerë në ato përpjekje. Dhe, mendoj se sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo e ka dëshmuar këtë me emërimin e Matthew Palmerit, një nga zëvendësit e mi, përfaqësues të posaçëm për Ballkanin Perëndimor, për t'u përqendruar direkt në këtë çështje. Presidenti Donald Trump e ka mbështetur këtë me emërimin e ambasadorit tonë në Gjermani, Richard Grenell, të dërguar të posaçëm të presidentit për negociatat paqësore midis Serbisë dhe Kosovës, për t'i shtuar dimension politik, për të treguar se ne besojmë se ky është një proces i rëndësishëm dhe se Shtetet e Bashkuara do të bëjnë gjithçka të mundur për ta ndihmuar këtë proces", ka thënë Reeker.
Në pyetjen nëse Shtetet e Bashkuara e mbështesin idenë e ndryshimit të kufijve, Reeker ka thënë se ne nuk jemi të përqendruar në këtë çështje. Jemi të përqendruar në atë që dy vendet të gjejnë rrugë përpara dhe të paracaktojnë ide për gjetjen e zgjidhjes. Nuk ka rrugë për ta bërë atë.
Lidhur me shqetësimet për paralajmërimet se ndryshimi i mundshëm i kufijve midis Kosovës dhe Serbisë mund të ketë efekt domino në rajon, Reeker ka thënë se është një justifikim i të tjerëve për të mos ecur përpara, kur ata fokusohen në gjëra që imagjinojnë përpara se të ndodhin.
"Negociatat janë negociata. Dhe ky është kuptimi i dialogut: të ulesh dhe të bisedosh për mundësitë, për ndërtimin e besimit midis dy vendeve. Andaj, ne i kemi ofruar zyrat tona diplomatike, përfaqësuesin e posaçëm, të dërguarin e posaçëm të presidentit, për të ndihmuar në ndërtimin e kësaj dhe për të punuar me kolegët tanë evropianë, për ta lëvizur gjithë procesin dhe rajonin përpara, për një të ardhme më të mirë për secilin atje", ka thënë Philip Reeker.
Në lidhje me gjasat që Kosova dhe Serbia të arrijnë marrëveshje paqësore, Philip Reeker ka thënë se shanset janë reale dhe besojmë se ka vullnet te të dyja palët.
"Më e rëndësishmja, ka një dëshirë të madhe te të gjithë njerëzit në rajon që të jetojnë në paqe, të gjejnë mënyra për të ecur përpara, me synimin për integrim të plotë në institucionet evropiane dhe transatlantike dhe për të gjetur mënyra për siguri më të mirë, për stabilitet dhe mirëqenie për të gjithë njerëzit në rajon. Unë besoj se kjo është ajo që duan ta shohin edhe udhëheqësit në Serbi, edhe në Kosovë. Çështja është gjetja e dinamikës së duhur, gjetja e zotësisë për të ecur përpara. Dhe, me këtë ka të bëjë e gjithë diplomacia", ka thënë Philip Reeker.

# Basha: Rinia shqiptare, dështimi më i madh i kësaj Qeverie



TIRANË, 31 TETOR - Ka nisur nga Tirana turi kombëtar i Lulzim Bashës me të rinjtë shqiptarë. Në bashkëbisedimin me të rinjtë e Forumit Rinor Demokrat, lideri opozitar tha se dështimi më i madh i Qeverisë së Edi Ramës është dështimi me të rinjtë.
"Nuk është faji i shqiptarëve, është kusuri i shqiptarëve. Është kusuri i një Qeverie që nuk ka lënë askënd më shumë në baltë sesa të rinjtë. Dështimi më i madh është dështimi me rininë, e cila po rritet në një vend pa mundësi, pa punësim, pa perspektivë, me rroga të ulëta minimale dhe me kosto maksimale të jetës dhe arsimit. Me një vend me klimë të shkatërruar për biznesin dhe ekonominë. Në një vend ku kërkesa e parë e rinisë, fatkeqësisht, është largimi nga vendi", tha Basha.
Por kreu i PD-së u zotua se kjo situatë nuk ka për qenë kështu edhe për shumë kohë, pasi vendi e ka të gjithë potencialin e nevojshëm për të ndryshim.
"Do realizojmë një reformë të thellë në arsim ku në themel të jetë studenti dhe e ardhmja e tij. Na duhet një Qeveri që ka vizionin dhe pasionin për t'ju vënë ju të parët dhe jo interesat e një grupi njerëzish të cilët e kanë tradhtuar interesin e qytetarëve shqiptarë. Ne kemi treguar se e kemi këtë vizion", tha Basha.

## Kalon rezoluta që formalizon hetimet për shkarkimin e Trumpit

UASHINGTON, 31 TETOR - Dhoma e Përfaqësuesve e Kongresit amerikan miratoi të enjten një rezolutë që vë në lëvizje zyrtarisht procesin përmes së cilit komisionet do të vazhdojnë hetimin për të përcaktuar nëse presidenti Trump duhet të përballet me shkarkim.
Votimi tregoi përçarjen në Dhomën e Përfaqësuesve mes demokratëve të shumicës, udhëheqësit e së cilëve kishin argumentuar se nuk ishte e nevojshme një rezolutë e tillë për ta bërë procesin legjitim dhe pakicës republikane që deri tani e ka kundërshtuar hetimin duke thënë se është një proces shumë hermetik dhe se atyre nuk u është dhënë një rol i barabartë
"Po e ndërmarrim këtë hap për të eliminuar çdo dyshim nëse administrata e presidentit Trump mund të bllokojë dokumente, t'i pengojë dëshmitarët, t'i shpërfillë thirrjet e autorizuara për detyrim paraqitjeje, apo të vazhdojë të pengojë Dhomën e Përfaqësuesve", tha kryetarja e Dhomës së




Përfaqësuesve, Nancy Pelosi në një letër për ligjvënësit demokratë.
Kryetari i shumicës republikane në Senat, Mitch McConnell tha se rezoluta nuk sjell drejtësi dhe nuk siguron procesin e duhur për hetimin.
Deri tani, komisionet e Dhomës së Përfaqësuesve për Zbulimin, Marrëdhëniet me Jashtë dhe Mbikëqyrjen kanë dëgjuar dëshmi me dyer të mbyllura nga diplomatë dhe zyrtarë të tjerë, ndërsa hetojnë nëse duhet votuar që Trumpi të shkarkohet se ka nxitur një vend të huaj, Ukrainën që të gjejë informacion dëmtues për një rival politik me qëllimin për të shtuar shanset për rizgjedhjen e vet.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Mbahet takimi i radhës në mes të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës

# Grupet punuese të LV-së dhe të LDK-së diskutojnë për sigurinë dhe drejtësinë



**Grupet punuese të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) janë takuar sërish të enjten, me ç'rast kanë diskutuar për sigurinë e jashtme dhe të brendshme, për procesin e vetingut, për ligjin për shqyrtimin dhe verifikimin e pasurisë së pajustifikueshme, për trajtimin e krimeve të luftës dhe për krijimin e mekanizmave shtetërorë për dokumentimin dhe arkivimin e krimeve të luftës në Kosovë, si dhe për krijimin e një organi të posaçëm për hetime me qëllim të dekriminalizimit të institucioneve shtetërore**

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 TETOR - Në selinë e Lëvizjes Vetëvendosje të enjten është mbajtur takimi i radhës i grupeve punuese të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, në të cilin është diskutuar për sigurinë e jashtme dhe të brendshme, për procesin e vetingut, për ligjin për shqyrtimin dhe verifikimin e pasurisë së pajustifikueshme, për trajtimin e krimeve të luftës dhe për krijimin e mekanizmave shtetërorë për dokumentimin dhe arkivimin e krimeve të luftës në Kosovë, si dhe për krijimin e një organi të posaçëm për hetime me qëllim të dekriminalizimit të institucioneve shtetërore.

Diskutimi u zhvillua në një frymë pozitive dhe shumë konstruktive. Për shumicën e çështjeve u gjet pajtim i përbashkët. Grupet u morën vesh për hollësi edhe të disa çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë.

Pas këtij takimi ka folur deputeti nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Arben Gashi, i cili ka treguar se sot janë diskutuar temat nga sundimi i ligjit dhe siguria. Ai ka thënë se synim kryesor i këtij koalicioni gjatë këtij mandati është themelimi i Zyrës Shtetërore të Hetimeve. "Kemi folur edhe për krijimin e një zyre për hetime që do të quhet Zyra Shtetërore e Hetimeve. Zyra Shtetërore e Hetimeve do t'i ketë katër komponentë. Komponenti i parë është luftimi i krimit të organizuar, i dyti do të jetë hetimi i krimeve të vjetruara dhe politike, i treti do të jetë lufta kundër korrupsionit dhe, i fundit, hetimi i pasurisë së zyrtarëve të përfshirë", ka bërë me dije Gashi.

Ndërkaq anëtari i Kryesisë i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka bërë me dije para dy ditësh se nuk ka zvarritje për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje në mes të LDK-së dhe Lëvizjes Vetëvendosje. Ai ka thënë se kjo marrëveshje do të ndodhë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve. Hoti ka treguar se qeveria e re do t'i ketë vetëm 12 ministri që do t'i kursejë shtetit miliona euro. Takimi i radhës në mes të grupeve të LV-së dhe të LDK-së do të mbahet të hënën, në të cilin do të diskutohet për arsimin dhe shëndetësinë.

# Pacolli, ministrave të jashtëm: Njohja e Kosovës, kontribut për paqen në rajon

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme i Republikës së Kosovës, Behgjet Pacolli, të enjten u është drejtuar ministrave të punëve të jashtme të vendeve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Frankofonisë, në Monako, ku po zhvillohet konferenca e 38 e kësaj organizate. Aty Pacolli ka prezantuar arritjet e Republikës së Kosovës dhe angazhimin e saj për misionin e Frankofonisë.

Shefi i diplomacisë së Kosovës me këtë rast ka theksuar nevojën që bashkësia ndërkombëtare të vazhdojë ta mbështesë shtetin e Kosovës në nivelin botëror pasi, siç ka thënë ai, qasja e këtillë është kontributi më i rëndësishëm për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe është njohje e rolit konstruktiv që luan Kosova. "Ne do të vazhdojmë të angazhohemi me të gjitha vendet në mënyrë miqësore dhe bashkëpunuese, por u bëj thirrje të gjitha shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën deri më tani, ta marrin këtë vendim dhe të na mbështesin në përpjekjen tonë për anëtarësim edhe në organizata të tjera ndërkombëtare", ka thënë Pacolli.

Në margjinat e kësaj konference Pacolli ka zhvilluar shumë takime bilaterale me ministra të jashtëm të hapësirës frankofone. "Qëllimi është ta vazhdojmë angazhimin tonë për ta kundërshtuar agresionin diplomatik dhe propagandistik serb dhe t'ia shpjegojmë botës mënyrën e ndyrë që Serbia po përdor kundër Kosovës", ka deklaruar Pacolli.

Kosova është anëtarësuar në Organizatën Ndërkombëtare të Frankofonisë si anëtare vëzhguese në vitin 2014, ndërsa në tetor të vitit të kaluar asaj i është ngritur statusi në anëtare të asociuar.






KRYETARI I NISMËS SOCIALDEMOKRATE, FATMIR LIMAJ, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

# Limaj: Papërgjegjshmëria e KQZ-së ka rrënuar procesin dhe integritetin zgjedhor

**Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vlerësuar se procesin zgjedhor të 6 tetorit e kanë përcjellë keqadministrimi, papërgjegjësia dhe standardet e dyfishta. Në një konferencë për media ai ka thënë të enjten se KQZ-ja i ka ikur përgjegjësisë kushtetuese për administrimin e zgjedhjeve duke mos marrë vendime që ia përcakton ligji. Limaj ka theksuar se ikja e vazhdueshme e KQZ-së nga vendimmarrja ka rrënuar integritetin e zgjedhjeve dhe ka shkaktuar pasoja gati të pariparueshme. Sipas tij, papërgjegjshmëria e KQZ-së ka rrënuar procesin dhe integritetin zgjedhor. Limaj ka thënë se edhe vendimet e Gjykatës Supreme janë pasojë e sjelljes kaotike e të papërgjegjshme të KQZ-së**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 31 TETOR - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, të enjten ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka prezantuar shqetësimet e koalicionit Nisma-AKR-PD që kanë të bëjnë me administrimin e procesit zgjedhor. Me këtë rast, ai ka thënë se procesi i 6 tetorit ishte nga më të mirët, por devijoi gjatë administrimit. "Dita e zgjedhjeve të 6 tetorit nga mëngjesi e deri në mbylljen e vendvotimeve ishte një nga ditët më të mira që kur mbahen zgjedhjet në Kosovë. Çdo gjë shkoi sipas ligjit, duke mos u raportuar asnjë shkelje serioze dhe qytetarët kryen obligimin e tyre në përputhje me ligjin. Me të drejtë të gjithë shpresuam se këto do të jenë zgjedhjet më të mira që janë mbajtur ndonjëherë në Kosovë. Por, problemet filluan të shfaqen në fillimin e administrimit të procesit zgjedhor", ka deklaruar Limaj. Ai ka rikujtuar se problemi i parë u shfaq te formulari i cili ishte me defekte dhe i njëjti ishte shpërndarë në të gjitha qendrat e votimit. Limaj ka thënë se këtë defekt KQZ-ja nuk e kishte parë derisa filluan të dorëzohen votat e numëruara nga qendrat e votimit në Qendrën e Numërimit të Rezultateve. "Në mbledhjen e vet KQZ-ja pranoi gabimin se ka pasur defekte në formularë dhe se procedimi i mëtutjeshëm i votave me ata formularë me gabime ishte i pamundur, ishte konstatim i KQZ-së. Fajin për këtë gabim në formular KQZ-ja ia la sekretariatit të vet dhe si rezultat i saj, në vend se t'i rinumërojë të gjitha votat e 6 tetorit, KQZ-ja vendosi për rinumërim të mbi 800 kutive. Kërkesa jonë ishte që të bëhet rinumërimi i plotë për shkak të atij formulari me defekte", është shprehur Limaj, duke shtuar se procesin zgjedhor e kanë përcjellë keqadministrimi, papërgjegjësia dhe standardet e dyfishta. "Asnjëherë nuk ka pasur keqadministrim si deri më tani dhe KQZ-ja si asnjëherë më parë i ka ikur përgjegjësisë së saj kushtetuese për administrimin e zgjedhjeve duke i ikur detyrës së saj për të marrë vendime dhe për ta drejtuar e administruar procesin zgjedhor ashtu siç ia përcakton ligji. Detyra kryesore e KQZ-së është për të marrë vendim dhe neglizhenca, ikja e vazhdueshme e KQZ-së nga vendimmarrja, ka rrënuar integritetin duke vënë në pikëpyetje kredibilitetin e këtyre zgjedhjeve, duke shkaktuar pasoja gati të pariparueshme", ka theksuar ai.

Limaj ka thënë se sjelljet kaotike dhe të papërgjegjshme të KQZ-së kanë sjellë edhe vendimet e Gjykatës Supreme. Sipas tij, shqetësimet e ngritura nga disa anëtarë të KQZ-së e tregojnë më së miri se ky organ gjatë këtij procesi ka qenë tërësisht jofunksional duke mos kryer detyrën që ia kanë përcaktuar ligji dhe Kushtetuta. "Vendimet e Gjykatës Supreme janë pasojë e sjelljes kaotike e të papërgjegjshme të KQZ-së. Sot u pa se sa joserioze, konfuze e kaotike ishte mbledhja e KQZ-së. Shqetësimet e ngritura nga disa anëtarë të KQZ-së e tregojnë më së miri se ky organ gjatë këtij procesi ka qenë tërësisht jofunksional, kaotik, duke mos kryer detyrën që ia kanë përcaktuar ligji dhe kushtetuta. Prandaj sot KQZ-ja nuk kishte përgjigje për situatën e krijuar. Sot u tha që më 17 tetor kanë ardhur mbi 1 800 fletëvotime 11 ditë pas procesit zgjedhor dhe askush nuk ishte në gjendje të jepte përgjigje se çka duhet bërë me këto vota të ardhura me këtë datë. Për më tepër, sot kryetarja e KQZ-së deklaronte vazhdimisht se KQZ-ja nuk merr vendime për këto tema. Atëherë për çka është krijuar KQZ-ja?! Duke ikur nga përgjegjësia dhe duke mos marrë vendime për paketat e kontrabanduara nga Serbia, në vazhdimësi KQZ-ja ka shkelur ligjin zgjedhor dhe, në anën tjetër, nga shkelja e vazhdueshme nga KQZ-ja ka ardhur si pasojë

# KQZ-ja zbaton vendimin e Supremes për numërimin e mbi 4 000 votave të diasporës

Mbi 4 000 vota të ardhura me vonesë nga diaspora do të numërohen dhe do të përfshihen në rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve parlamentare të 6 tetorit. Kështu ka deklaruar në mbledhjen e së enjtes kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Valdete Daka

EPOKA E RE Faton DERMAKU

PRISHTINË, 31 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e së enjtes ka diskutuar për aktgjykimin e Gjykatës Supreme për numërimin e 4 639 votave të ardhura me vonesë nga diaspora. Me këtë rast, kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se në bazë të këtij vendimi janë të obliguar t'i numërojnë këto fletëvotime. "Në bazë të këtij aktgjykimi jemi obliguar që t'i numërojmë fletëvotimet nga diaspora. E kemi obligimin dhe nuk mendoj se kemi çfarë të diskutojmë. Na pëlqeu, nuk na pëlqeu, do ta zbatojmë", ka deklaruar ajo.

Por për këtë vendim ka pasur mospajtime nga anëtarët e KQZ-së.

Anëtari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ilir Gashi, ka thënë se me këtë vendim të Gjykatës Supreme ka ndryshuar Ligji për zgjedhjet. Ai ka kërkuar sqarim se çfarë do të ndodhë me 1 700 votat që kanë ardhur më 17 tetor. "Dua të sigurohem se në bazë të ankesave vendimi nuk ka të bëjë me 1 700 votat që kanë ardhur më 17 tetor. Realisht po bëhet precedent për këtë çështje, se me këtë vendim po ndryshohet edhe Ligji për zgjedhje. Dilemë kam se çfarë do të bëhet me 1 700 me votat që kanë ardhur më 17 tetor", ka thënë Gashi.

Edhe anëtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Sami Hamiti, ka thënë se vendimi i Supremes është në kundërshtim me Ligjin për zgjedhje. Madje, ai ka ironizuar duke thënë se mos ka mbetur edhe ndonjë pako në Merdar.

Ndërkaq anëtari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Adnan Rrustemi, e ka vlerësuar të drejtë këtë vendim. "Aktgjykimi nuk mund të diskutohet. Konsideroj se është vendim i drejtë", ka theksuar ai.

Në këtë mbledhje të KQZ-së, Besnik Buzhala nga Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka bërë me dije se janë edhe 1 806 fletëvotime të ardhura pas afatit, për çka ka kërkuar sqarime se çfarë do të bëhet me to. Ai ka thënë se arsyeja e vonesës së tyre është e njëjtë sikurse e 4 639 fletëvotimeve për të cilat ka marrë vendim Gjykata Supreme që të numërohen.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka thënë se nuk do të marrin vendim për këto vota por, sipas saj, i mbetet shërbimit të votuesve që të vendosë se çka të bëhet me to.






edhe vendimi i Gjykatës Supreme që ndryshon Ligjin për zgjedhje", është shprehur Limaj. Ai ka thënë se kjo situatë e krijuar nga KQZ-ja ka rrënuar procesin dhe integritetin zgjedhor.

Limaj ka theksuar se është për keqardhje që një proces i cili ka filluar mirë të vihet në pikëpyetje për shkak të moskryerjes së detyrës nga KQZ-ja. "Tani me çfarë ligji po administrohet procesi zgjedhor? Cila është siguria juridike? Në krejt këtë situatë të cilën e ka krijuar papërgjegjshmëria e KQZ-së, kemi ardhur në situatën në të cilën janë rrënuar procesi dhe integriteti zgjedhor. Kjo gjendje kaotike është rezultat i sjelljes së papërgjegjshme të KQZ-së, e cili nuk e ka administruar këtë proces. Është gjynah që një proces i cili ka filluar mirë, të vihet në pikëpyetje për shkak të moskryerjes së detyrës nga KQZ-ja. Asnjëherë nuk ka pasur administrim më të keq zgjedhor. Është vështirë të thuhet mbi bazën e cilit ligj do të bëhet certifikimi i rezultatit zgjedhor", ka theksuar ai, duke paralajmëruar se do t'i denoncojnë të gjithë shkelësit e ligjit dhe ata që e kanë dëmtuar integritetin e zgjedhjeve. "Ne po përcjellim nga afër krejt këto zhvillime dhe do të vijë një çast kur do të dalim dhe t'i adresojmë ata njerëz që kanë marrë përsipër ta rrënojnë integritetin e këtyre zgjedhjeve. Heshtja në institucion dhe veprimi që kanë ndodhur, tregojnë më së miri se këtu ka edhe veprime të qëllimshme për ta rrënuar integritetin e zgjedhjeve. Ne me kohë do t'i denoncojmë të gjithë shkelësit e ligjit dhe ata që e kanë dëmtuar integritetin e zgjedhjeve", ka deklaruar Limaj.

## DnV-ja: Vendimi i Gjykatës Supreme, jo i drejtë

Demokracia në Veprim (DnV) ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës Supreme për pranimin dhe vlerësimin e fletëvotimeve të ardhura me vonesë nga diaspora, ndonëse është i zbatueshëm, është jo i drejtë dhe përbën një precedent që mund ta ndikojë negativisht në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore në Kosovë. "Vlerësojmë se vendimi i Gjykatës Supreme, për pranimin dhe vlerësimin e këtyre pakove si të rregullta, ndonëse është i zbatueshëm, është jo i drejtë dhe përbën një precedent që mund ta ndikojë negativisht mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore në Kosovë. Duke marrë në konsideratë kompleksitetin e krijuar lidhur me votimin jashtë vendit në këto zgjedhje, DnV kërkon që kjo çështje të jetë një nga prioritetet kryesore që duhet të adresohet në kuadër të reformës zgjedhore", është thënë në komunikatën për medie të DnV-së.

Më tutje, është thënë se DnV-ja njeh dhe respekton të drejtën qytetarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë vendit mirëpo, sipas DnV-së, kjo e drejtë duhet të ushtrohet duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore të përcaktuara në kuadër të legjislacionit zgjedhor. "DnV ka ndjekur të gjitha zhvillimet lidhur me pakot me fletëvotime të supozuara, të cilat kanë ardhur me vonesë nga diaspora. DnV njeh dhe respekton maksimalisht të drejtën universale të të gjithë qytetarëve të Kosovës për të zgjedhur, në këtë rast qytetarëve me të drejtë vote që jetojnë jashtë vendit. Mirëpo, kjo e drejtë duhet të ushtrohet duke respektuar procedurat dhe afatet ligjore të përcaktuara në kuadër të legjislacionit zgjedhor. DnV konsideron se qëllimi për të cilin janë vendosur procedurat dhe afatet ligjore për ushtrimin e të drejtës së votimit nga jashtë është i bazuar edhe në praktikat ndërkombëtare dhe, si i tillë, i shërben garantimit të integritetit dhe rregullsisë së procesit zgjedhor", është theksuar në komunikatën e DnV-së.

## Vazhdojnë punimet për rehabilitimin e rrugës që lidh fshatrat Dedaj dhe Lugishtë e Hasit



PRIZREN, 31 TETOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se janë duke vazhduar punimet për rehabilitimin e rrugës që lidh fshatrat Dedaj dhe Lugishtë e Hasit. Kjo komunë ka theksuar se rehabilimitimi i kësaj rruge buxhetit komunal do t'i kushtojë rreth 250 mijë euro. "Në këtë rrugë, që ka gjatësi rreth 6 kilometra dhe gjerësi 5 metra, është bërë mbulimi i gropave, pastrimi i terrenit përskaj rrugës, shtrimi i shtresës së re me asfalt dhe së fundi do të bëhet edhe sinjalizimi vertikal dhe horizontal i saj. Projekti i rrugës Dedaj - Lugishtë e Hasit është realizuar në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe vlera e tij arrin në rreth 250 mijë euro", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

# INPO: Mbi 41 për qind e qytetarëve të kënaqur me shërbimet komunale në Prishtinë




PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Organizata Iniciativa për Progres (INPO) ka publikuar raportin vjetor "Indeksi i kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale në Prishtinë", ku nga ky raport ka dalë se mesatarja aritmetike e kënaqshmërisë me të gjitha shërbimet komunale është 41.99 për qind, kurse pakënaqësia është 29.56 për qind. Drejtoresha ekzekutive e Iniciativës për Progres (INPO), Albulena Ndrecaj, ka thënë se, krahasuar me indeksin e kënaqshmërisë nga viti i kaluar, ka rritje për rreth 2 për qind për shërbimet komunale por, sipas saj, ka edhe rënie të kënaqshmërisë për disa shërbime. Ndrecaj ka bërë me dije se në këtë indeks janë përfshirë gra dhe burra të moshës 18-vjeçare që kanë treguar vlerësimet e tyre rreth 15 shërbimeve komunale që i ofron Komuna e Prishtinës. Ndërsa nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal, Shkëlzen Jakupi, ka thënë se këto të dhëna përputhen me indeksin e kënaqshmërisë së shërbimeve komunale të Prishtinës të cilat i ka bërë kjo ministri. Në anën tjetër, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Muhedin Nushi, ka thënë se rezultatet kanë qenë të pritshme. Me këtë rast, Nushi ka thënë se si komunë janë duke punuar që ta rrisin nivelin e çdo shërbimi komunal.

# Shtatë persona akuzohen në Gjakovë për veprën penale 'Cenimi i fshehtësisë së votimit'



GJAKOVË, 31 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka njoftuar se ka ngritur shtatë aktakuza kundër shtatë personave të dyshuar, L. G., A. H., E. Ll., B. J., Xh., K. N., B. H., për veprën penale "Cenimi i fshehtësisë së votimit", nga neni 215 i KPRK-së. "Më 06. 10. 2019, nëpër qendra të ndryshme të votimit, në Gjakovë e Rahovec, për derisa ka qenë duke u zhvilluar procesi i votimit. Të dyshuarit e lartcekur kanë cenuar fshehtësinë e votimit, duke e fotografuar fletëvotimin me telefonat e vet personalë. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se të njëjtët kanë përmbushur elementet e veprës penale të përshkruar më lart", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
Dy prokurorët e rasteve i kanë propozuar Gjykatës Themelore në Gjakovë që të pandehurit L. G., A. H., E. Ll., B. J., Xh., K. N., B. H., të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila iu vihet në barrë.

## Komuna e Kaçanikut finalizon disa projekte kapitale



KAÇANIK, 31 TETOR (ER) - Komuna e Kaçanikut ka njoftuar se projekte të shumta komunale tashmë kanë hyrë në fazën e fundit të implementimit. Kryetari i kësaj komune, Besim Ilazi, ka inspektuar nga afër ecurinë e asfaltimit të rrugës "Çamëria", segmenti Bajnicë - Rakaj si dhe asfaltimin e rrugëve në lagjen Prushaj-Lamaj-Soponicë". Me këtë rast, Ilazi ka përgëzuar banorët e kësaj ane për rrugët të cilat janë duke u asfaltuar, të cilat, sipas tij, do ta lehtësojnë qarkullimin dhe do ta ngritin cilësinë e jetesës. Ai ka thënë se institucionet komunale do të jenë të përkushtuara për krijimin e kushteve sa më të mira për të gjithë qytetarët, ndërsa edhe banorët janë shprehur të kënaqur dhe falënderues për asfaltimin e rrugëve të cilat do të mundësojnë një jetesë më të mirë në këto anë.
Rregullimi i rrugëve në lagjen Prushaj-Lamaj-Soponicë është duke u financuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe Komuna e Kaçanikut, ndërsa projekti "Çamëria", segmenti Bajnicë - Rakaj, është duke u realizuar në kuadër te memorandumit me Ministrinë e Infrastrukturës. Po ashtu, kryetari Ilazi ka inspektuar punimet edhe në rrugën "Milaim Loku" në Kotlinë, ku është duke u bërë zgjerimi i trasesë dhe shtruarja me zhavorr e kësaj rruge që përfshinë një gjatësi prej një kilometër. Përmes kësaj rruge synohet funksionalizimi i rrugës Kotlinë-Glloboqicë.

## Thaçi kërkon nga senatorja franceze përkrahje konkrete nga shtetet anëtare të BE-së

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të enjten anëtaren e Senatit të Francës, Helen Conway-Mouret, me të cilën ka biseduar për zhvillimet në Kosovë dhe rajon. Presidenti Thaçi u shpreh se Kosova ka zhvilluar një proces elektoral shembullor dhe se tani po pret formimin e qeverisë së re. "Kosova ka një demokraci të avancuar", u shpreh presidenti Thaçi dhe shtoi se pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve pret që shpejt të formohet qeveria që do t'i shtyjë përpara proceset e rëndësishme për Kosovën. Presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova dhe i tërë Ballkani Perëndimor pret përkrahje më konkrete nga BE-ja. "Kosova ka përmbushur kushtet për liberalizim të vizave dhe pret vendim meritor nga BE-ja dhe shtetet anëtare të BE-së", ka thënë presidenti Thaçi.

Senatorja Conway-Mouret u shpreh se Franca përkrah perspektivën evropiane të Kosovës dhe të tërë Ballkanit Perëndimor.

Presidenti Thaçi ka thënë se Kosova nuk ka alternativë tjetër përveçse të vazhdojë të angazhohet për të realizuar aspiratën për t'u bërë anëtare e BE-së.



# Në Bruksel nënshkruhet marrëveshja për zbatim të planit të përbashkët të veprimit kundër terrorizmit



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 31 TETOR - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka qëndruar në një vizitë zyrtare në Bruksel. Në kuadër të kësaj vizite ministri Mustafa ka nënshkruar marrëveshjen për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Ministri në detyrë, Mustafa, ka falënderuar komisionarin Avramopoulos për mbështetjen e tij të vazhdueshme në proceset integruese të Republikës së Kosovës dhe për forcimin e kapaciteteve në fushën e sundimit të ligjit. Ai ka theksuar se Kosova si anëtare e Koalicionit Global kundër ISIS, por edhe duke u bazuar në obligimet nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, është treguar partnere e besueshme e Bashkimit Evropian në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ministri Mustafa e ka njoftuar komisionarin Avramopoulos rreth zbatimit të programeve të deradikalizimit dhe riintegrimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Komisionari Avramopoulos e ka përgëzuar Qeverinë e Republikës së Kosovës për veprimin e guximshëm të treguar me rastin e kthimit të qytetarëve nga zonat e konfliktit dhe i ka nxitur institucionet ta vazhdojnë punën profesionale dhe zbatimin e Planit të Përbashkët.

Marrëveshja e nënshkruar buron nga Plani i Përbashkët i Veprimit Kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor i nënshkruar nga ministrat e brendshëm të Ballkanit Perëndimor më 5 tetor 2018 në Tiranë. Në këtë marrëveshje parashihen pesë objektiva dhe aktivitete specifike që do të realizohen në vitin 2019 dhe 2020 për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

## Policia realizon aksion në 46 lokale të ndryshme, mbyll 10 prej tyre

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Sektori i Hetimeve nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, në bashkëpunim dhe mbështetje të inspektorëve komunalë, inspektorëve të punës, zyrtarëve të ATK-së, inspektorëve të MTI-së dhe njësive të tjera të profilizuara, në kuadër të PK-së, ka realizuar operacionin policor, duke realizuar kontrolle dhe inspektime rutinore në bare dhe lokale të ndryshme. Gjatë realizimit të operacionit policor janë kontrolluar: 46 lokale (10 prej tyre janë mbyllur nga inspektorët komunalë si dhe janë shqiptuar gjoba për mungesë të arkave fiskale). "Janë gjetur armë të ftohta (3 thika), 2 boksa të metalit dhe 1 sprej OC (1). Janë legjitimuar gjithsej 296 persona, 86 meshkuj dhe 210 femra, të cilët, në mungesë të lejes së punës dhe qëndrimit, janë trajtuar nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj për t'i vazhduar procedurat e tjera. Ky aktivitet parandalues është zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha rajonet brenda këtij muaji në intervale të ndryshme kohore", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



# Dënimi i Serbisë për gjenocid i hapë rrugë paqes së qëndrueshme në Evropën Juglindore



Shkruan: Jakup KRASNIQI

Angazhimi i BE-së dhe i ShBA-së për t'i bërë bashkë liderët e Evropës Juglindore, sidomos të Ilirikut, për gjetjen e rrugëve dhe mënyrave për të ndërtuar një paqe të përhershme, siguri të plotë dhe zhvillim të qëndrueshëm në Evropën Juglindore dhe Ilirikun Perëndimor, do të kishte një rëndësi të madhe për çdo shtet e qytetar të kësaj pjese të Evropës.

Në këtë shkrim do të përqendrohem në një temë konkrete që është shndërruar në pengesë të pakapërcyeshme në procesin e ndërtimit të paqes së mirëfilltë në këtë pjesë të kontinentit tonë. Bëhet fjalë për mohimin e gjenocidit. Kjo çështje do të duhej të kishte një vëmendje të shtuar nga të gjitha vendet e kontinentit të vjetër e sidomos nga vendet e demokracisë euroatlantike.

Ata që kanë ndjekur zhvillimet politike gjatë shpërbërjes së ish-Federatës së Jugosllavisë në dy dekadat e fundit të shekullit XX e dinë fare mirë se në Kroaci, në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë është kryer gjenocid. Përderisa në Kroaci dhe në Bosnjë-Hercegovinë përgjegjësia e shtetit të Serbisë ishte e maskuar në atë mënyrë që fajtorët të kërkohen në strukturat e serbëve lokalë, në luftën e Kosovës gjërat janë shumë të qarta: Serbia si shtet përpiloi projektin e gjenocidit dhe e vuri në zbatim gjatë periudhës 1998-1999 përmes policisë dhe ushtrisë së saj. Përgjatë krimit të gjenocidit të kryer në Kosovë, forcat serbe vranë 1392 fëmijë shqiptarë, 1739 gra shqiptare dhe rreth 10 mijë civilë të tjerë shqiptarë të të gjitha moshave, me qëllim që të shkatërrohen tërësisht ose pjesërisht shqiptarët e Kosovës si tërësi kompakte kombëtare, etnike apo fetare e ndryshme nga serbët.

Shteti serb edhe 20 vjet pas luftës jo vetëm që nuk i ka ballafaquar me drejtësinë përgjegjësit e gjenocidit kundër shqiptarëve, nuk kanë treguar asnjë shenjë pendimi, përkundrazi, shtetit serb po vazhdon të mbajë të fshehura kufomat e mbi 1 600 civilëve shqiptarë, të cilët pas vrasjeve ishin zhvarrosur dhe transferuar në Serbi me qëllim të zhdukjes së gjurmëve dhe fakteve të gjenocidit.

Vetëm ata që kanë përjetuar situata të ngjashme, ku me dhjetëra mijëra familje nuk kanë mundur ta përfundojnë zinë për anëtarët e vrarë të familjes, e dinë se sa e vështirë është të ndërtohet paqja në këtë kontekst shoqëror. Kur flasim për pasojat e luftës nuk duhet të harrohet se prapa kategorisë "të zhdukur gjatë luftës në Kosovë" janë dhjetëra mijëra varre të hapura në shpirtin e të afërmve të atyre viktimave që u zhdukën në funksion të realizimit të gjenocidit kundër shqiptarëve.

Që të mund të përfundojë procesi i zisë, këto familje dhe shoqëria që ka përjetuar këtë krim të shëmtuar kanë nevojë të ndriçohet në tërësi fati i të gjitha viktimave.

Përveç sa u tha, Serbia gjatë zbatimit të politikës së gjenocidit në Kosovë ka bërë dhunë seksuale ndaj mbi 20 mijë femrave shqiptare, me qëllim të cenimit të rëndë të integritetit fizik, moral dhe mendor të femrës shqiptare. Asnjë kriminel serb nuk është dënuar për ushtrimin e kësaj forme të gjenocidit. Shqetësues në këtë rast është fakti se asnjë mekanizëm euroatlantik e ndërkombëtar nuk ka bërë presion të duhur mbi politikën serbe post millosheviqiane.

Serbia jo vetëm që nuk e ka pranuar përgjegjësinë, por në vazhdimësi ka zbatuar mohimin e gjenocidit në Kosovë si strategjinë e shkatërrimit të së vërtetës dhe kujtesës për gjenocidin. Kjo mënyrë e sjelljes e thellon hendekun mes dy vendeve, sepse pamundëson mbylljen e kapitullit të luftës. Por, përkundrazi, politika serbe e ka thelluar agresivitetin ndaj Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj. Madje edhe sot, 20 vjet pas krimeve të gjenocidit gjatë luftës, eksponentë të lartë shtetëror serbë e rusë kërcënojnë me luftëra të reja.

Më 16 maj 2019 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Rezolutën për gjenocidin e kryer serb në Kosovë. Emërtimi i gjërave me emrin e tyre përbën një akt thellësisht njerëzor, që lehtëson përballimin e dhembjes për të mbijetuarit e gjenocidit dhe nderon kujtimin e viktimave të gjenocidit. Nuk ka asnjë dyshim, ky veprim i Kosovës ka qenë i vonuar. Heshtja e Kosovës për gjenocidin që Serbia e ka ushtruar mbi shqiptarët, në vend që të kuptohet si vullnet i mirë e në shërbim të normalizimit të marrëdhënieve në mes Kosovës e Serbisë, ajo është detyruar ta bëjë një Gjykatë Speciale për përndjekje njëetnike dhe i ngarkohet faji për dështimin e dialogut!

Në interes të mbylljes së kësaj plage të madhe dhe hapjes së perspektivës së ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme në Evropën Juglindore është e udhës që SHBA-ja e BE-ja, t'iu drejtohen krerëve të institucioneve të Serbisë me kërkesën imediate që ky shtet të ndriçojë plotësisht fatin e të gjithë atyre që ende konsiderohen të zhdukur dhe të sjellë para drejtësisë përgjegjësit e krimit të gjenocidit. Dhe pa kushte t'i normalizojë marrëdhëniet me Kosovën. Gjithashtu, të kërkohet që Serbia ta pranojë këtë faj të rëndë dhe të bëhet prijëse për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën duke e njohur Republikën e Kosovës shtet të pavarur, sovran e demokratik, duke ia lehtësuar pranimin e saj nga pesë vendet e BE-së dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB.

Kjo është rruga për një paqe të qëndrueshme në Ilirik dhe Evropën Juglindore. Popujve të këtij rajoni dhe popujve në përgjithësi iu duhet paqja, siguria me zhvillim të qëndrueshëm për punësim e mirëqenie!

# Mbahet takimi i sigurisë lokale në Suharekë, java pa vjedhje



**Suharekë, 31 tetor (ER)** - Është mbajtur takimi i rregullt javor për koordinim lokal të sigurisë në Komunën e Suharekës. Në këtë takim të pranishëm ishin nënkryetarja e komunës Mihrije Suka, kryesuese e takimit, përfaqësuesi i policisë, përfaqësuesi i Zyrës për Informim, përfaqësuesi nga OSBE-ja dhe nga KFOR-LMT.

Nënkryetarja e komunës, Mihrije Suka, ka folur për aktivitetet që janë zhvilluar gjatë javës në këtë komunë. Ajo ka numëruar të gjitha takimet dhe ngjarjet, duke dhënë shpjegim të shkurtër për të gjitha ato që kanë ndodhur dhe ka specifikuar akademinë përkujtimore për ish-kryetarin e komunës, Ukë Bytyqi dhe diskutimet publike për legalizimin e objekteve nëpër fshatra.

Ndërsa komandanti i policisë, Milazim Lumi, ka raportuar për situatën e sigurisë në nivel komunal. Ai ka thënë se java ka qenë shumë e qetë dhe ka numëruar disa raste siç janë: dy aksidente trafiku, një lëndim trupor, një kanosje dhe 178 tiketa gjobe trafiku dhe pesë ligjërata të mbajtura në shkolla për dhunën në familje.

Nga OSBE-ja, Salih Elshani ka njoftuar se janë duke punuar në aktivitete për aspektet buxhetore, për auditimet dhe për përgatitjet e punëtorive të ndryshme.

Në fund LMT-KFOR ka deklaruar se është duke punuar në aktivitetet e përditshme dhe ka njoftuar se ka bërë vizita në disa ambulanca nëpër fshatra.

## Kuvendi Komunal i Deçanit voton ndryshimet statutare



**Deçan, 31 tetor (ER)** - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se Kuvendi Komunal ka votuar ndryshimet statutare. "Nga sot kemi një statut kompetent për funksionimin e komunës. Votimi u bë me 19 vota për, nga 27 gjithsej. Ndihem krenar që përfundoj një statut me shumë defekte. Ata që hezituan të jenë për, ndoshta kërkojnë falje ndonjëherë. Së paku grupit të juristëve të Deçanit", ka shkruar Ramosaj në llogarinë e vet në "Facebook".

# BQK-ja shënon Ditën Botërore të Kursimeve

PRISHTINË, 31 TETOR (ER) - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vazhduar traditën e shënimit të Ditës Botërore të Kursimeve. BQK-ja në kuadër të Programit të Edukimit Financiar, për të shënuar këtë ditë, ka organizuar garën për esenë më të mirë për nxënësit e klasave 6-9 të shkollave fillore të Kosovës që për temë kanë pasur "Kursimet për një të ardhme më të mirë".
Në ndarjen e çmimeve për nxënësit fitues, guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se kultura e kursimeve është një shprehi e mirë e njerëzve dhe familjeve. Mehmeti ka deklaruar se përmes eseve të shkruara nxënësit kanë vënë në sprovë komisionin për përzgjedhjen e emrave fitues për faktin se janë pranuar një numër i madh i punimeve, secila më e mirë se tjetra. "Kjo garë ishte shumë kreative, kishte shumë ese të mira dhe komisioni kishte punë shumë të vështirë për përzgjedhjen e fituesit. Unë mund të them se në këtë garë nuk kishte humbës. Të gjitha esetë ishin shumë të mira dhe kam nderin që sot t'i jap çmimet për më të dalluarit", ka deklaruar Mehmeti.
Nxënësit që fituan çmimet janë: Jon Boqolli, Albiona Barileva, Etrid Thaçi, Era Shabani, Lis Ademi, Tuana Aliu, Krenare Shefqeti, Elza Gosalci, Benar Sheqiri dhe Daorsa Imeri. Temat e eseve të dorëzuara ishin me tematikë për rëndësinë e kursimit për të ardhmen, qëndrimin e të rinjve ndaj kursimit, kursimet në institucionet financiare, mënyrat moderne kundrejt atyre klasike të pagesës, rolin e parasë dhe kursimit në ekonomi dhe mësimi për paranë në shkollë ndihmon se si të kursejmë.



Kjo ditë, e cila për herë të parë ishte shënuar në vitin 1924 në Kongresin Ndërkombëtar të Bankave të Kursimit në Milano të Italisë, tani festohet në mbarë botën, duke organizuar aktivitete të ndryshme, të cilat kanë për qëllim ta kultivojnë kulturën dhe t'i zhvillojnë shprehitë e kursimeve.

# Bizneset i delegojnë shqetësimet te kryetari i Prizrenit

PRIZREN, 31 TETOR (ER) - Rritja e taksave komunale, qendra e inovacionit, krijimi i komitetit për zhvillim ekonomik, mosfunksionalizimi i Zonës Ekonomike dhe kriteret për të qenë pjesë e saj ishin ndër çështjet kryesore të diskutuara në takimin e përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me kryetarin e Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka.
Kryetari i Bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka falënderuar kryetarin Haskuka për pritjen, duke e njoftuar për aktivitetet dhe prioritetet e Odës. Ai ka theksuar se ky takim u kërkua pasi që bizneset e konsideruan të nevojshëm diskutimin për sfidat me të cilat ata po përballen me komunën gjatë organizimit "Kafja e Mëngjesit" në Prizren që OAK-u është duke i mbajtur në komuna.
Pronari i biznesit "Nutriwell", Bujar Bilurdagi, ka kërkuar nga



Haskuka që të themelohet një komitet për zhvillim ekonomik, pasi që është më se e nevojshme dhe do t'i ndihmonte bizneset e reja që të fokusohen në sektorët për të cilët komuna ka nevojë më shumë. Ai ka shtuar se një nga problemet kryesore me të cilat bizneset po përballen është edhe mungesa e kuadrit profesional, e cila po i vështirëson punët për bizneset.
Dashmir Badallaj, pronar i biznesit "Badallaj.5" Sh. P. K., u fokusua te ndryshimi i taksave komunale që parashihet të ndodhë nga viti 2020, duke theksuar se një ndryshim i tillë do të ndikojë negativisht te bizneset e kësaj komune, andaj edhe u kërkua që Haskuka t'i ndërmarrë masat që janë nën kompetencë të tij.
Tafil Kalimashi, pronar i "Kosova Pack" Sh. P. K., ka kërkuar që bizneset të informohen paraprakisht për kriteret që kërkohen të plotësohen nga bizneset për të qenë pjesë e Zonës Ekonomike.
Ndërsa Edin Gashi, pronar i "Dallas" Sh. P. K., ka shtuar se infrastruktura që ka Zona Ekonomike është ndër arsyet kryesore pse bizneset janë të interesuara për të qenë pjesë e saj. Ndërsa Bafti Ismajli nga gurthyesi "Fitimi Commerce" ka pohuar për problemet e bizneseve të sektorit minerar dhe për vështirësitë që po hasin gjatë operimit.
Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka theksuar se Rregullorja për taksa është filluar nga qeveria e kaluar dhe se janë bërë shumë ndryshime nga drafti fillestar, ndërsa ajo pritet të hyjë në funksion nga 1 janar 2020. Ai ka shtuar se një nga problemet kryesore që po e hasin si komunë është reagimi i bizneseve ndaj vendimeve të ndryshme që ata po marrin, vetëm pas miratimit.
Haskuka ka theksuar se Komuna e Prizrenit është e interesuar të bëjë një strategji për zhvillim ekonomik dhe është e interesuar të bashkëpunojë me komunitetin e biznesit.

## Bizneseve në Gjakovë u prezantohen mënyrat e përkrahjes nga Ministria e Inovacionit

GJAKOVË, 31 TETOR (ER) - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN) ka marrë pjesë në konferencën informuese "Ditët e Biznesit të Vogël 2019", me bizneset e rajonit të Gjakovës, konferencë e organizuar nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), në bashkëpunim me Komunën e Gjakovës. Në këtë konferencë zyrtarët e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe të ministrive të tjera, që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik, kanë prezantuar programet përkrahëse për bizneset fillestare dhe ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme si dhe format me të cilat ata mund të përfitojnë për idetë dhe projektet inovative të bizneseve dhe individëve. "Gjatë konferencës të pranishmit u informuan për nismat dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet e Kosovës, të cilat kanë ndikim në zhvillimin e ndërmarrësisë në Kosovë. Gjatë prezantimit të aktiviteteve të MIN, të pranishmit janë informuar për nismat dhe shërbimet të cilat ofrohen nga kjo ministri, ku synim kryesor është rritja e kapaciteteve eksportuese të ndërmarrjeve kosovare dhe digjitalizimi i prodhimit dhe shërbimeve", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie.



# RAPORTI I INSTITUTIT ZVICERAN PËR R

**Gazeta "Epoka e re" në vazhdime do t'i botojë dy raportet e përkthyera në gjuhën shqipe, njërin prej 44 faqesh dhe tjetrin prej 15 faqesh, të Institutit të Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës, për rastin e Astrit Deharit. Këto dy raporte tashmë i ka Prokuroria Themelore në Prizren, familja e Astrit Deharit dhe avokati Tomë Gashi. Raporti publikohet pa asnjë ndërhyrje.**

- Disa zona lëkurore janë përshkruar vetën si të lënduara(ang. "wounded"), pa klasifikime tjera. Kemi të bëjmë me lëndime të regjionit frontal superior të djathtë, latero-cervikale të djathta dhe të pjesëve infero-interne të parakrahut të majtë. Ne i interpretojmë këto lëndime si pllaka pergamene.
- Gërvishtjet (ang. "scratches") me skaje të pastra dhe të rregullta, të përshkruara në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë dhe të kyçit të majtë, korrespondojnë me plagë sipërfaqësore dhe janë pasojë e traumave të shkaktuara me një objekt i mprehtë.

Disa lëndime që shihen në ekzaminim ekstern nuk janë përshkruar në raportin e autopsisë, kemi të bëjmë me këto lëndime :

- dermabrasion i regjionit pre-artikular i majtë i kuqërremtë, linear dhe horizontal, i vendosur në afërsi të tri zonave lëkurore të skuqura, me madhësi dhe formë të ndryshueshme, të një natyre të papërcaktuar,
- dilaceration sipërfaqësor i bregut lateral të djathtë të gjuhës, i vendosur përpar dilaceracerationit të përshkruar në raportin e autopsisë,
- ngjyrime të kuq-vjollce të mukozës të raphe të mesme të qiellzës së butë dhe të pjsës posteriore paramediane të djathë të qiellzës së butë, ndjellëse e zonës së infiltrimeve hemorragjike.

Interpretimi i lëndimeve të konstatuara mbi z. DEHARI Astrit:

Ecchymosis janë pasoja të traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse , presione lokale të forta). Ato janë shumë pak specifike ashtu që të mund të shprehemi për origjinën e tyre të saktë. Tri ecchymosis të vendosura në faqen mediale të kockave të vogla dhe distale të parakrahut të djathtë për nga lokalizimi dhe forma e tyre, mund evokojnë lëndime të shkaktuara nga një shtrëngim dore. Ato mund të shkaktohen dhe gjatë transportit të trupit ose të rianimimit mjekësor, ashtu siç janë propozuar nga mjekët ligjorë. Megjithatë një shtrëngim me dorë të llojit të mbajtjes nuk mund të përjashtohet dhe duhet të evokohet. Ecchymosis të vendosura në nivelin e këndit mandibular të djathtë dhe të nivelit të bregut antero-inferior të të djathtë të madibulës mud të jenë shkaktuar nga veprimet e reanimimit ( të llojit "headtilt/chin lift" ose "jaw thrust" në veçanti), por pak mund të flitet për lëndimet që lidhen me transportin e trupit. Ndër të tjera, këto Ecchymosis janë gjetur në lokalizime tipike të gjetura gjatë kapjes në qafë të llojit "çelësi i krahut" ose në forma tjera të dhunës kundër qafës, nga ky fakt, një mekanizëm i tillë i lëndimit nuk mund të përjashtohet dhe duhet të merret parasysh.

Pllakat pergamene janë pasojë e tharjes past-mortum të lëkurës, në shikim të zonave të pastrimit të epidermës pas traumave të hapura (përplasje e trupit kundër një apo shumë objekteve shtypëse, presione lokale të forta) me një përbërës tangjencial. Ato janë shumë pak specifike ashtu që të mundemi të shprehemi për origjinën e tyre të saktë. Ato të vendosur në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë, frontale superiore dhe në faqen anteriore të parakrahut të majtë munden, sipas mendimit të mjekëve ligjor, të jenë shkaktuar gjatë transportit të trupit, gjatë proceseve të rianimimit mjekësor ose nga "konvulsioni" që shoqëron obstruksionet e rrugëve ajrore gjatë kontaktit me një objekt të "skenës së krimit". Sipas observimeve tona numri i madh i pllakave të pergamenës të regjionit lateralo-cervikal, globalisht mund të ndahen në dy gupe. Grupi i parë përbëhet nga pllakat pergamene lineare, të pjerrëta për të poshtë dhe para trupit, globalisht paralele në mes veti, të vendosura në të njëjtin aks me plagët sipërfaqësore të të njëjtit lokalizim. Megjithatë ato janë shkaktuar nga një traumë e hapur dhe e topitur. Grupi i dytë përbëhet nga pllakat pergamene me madhësi dhe forma të ndryshme, disa në formë harku dhe në përgjithësi formojnë një hark të rrethit me konkavitet anterior. Sipas mendimit tonë nuk ka mekanizma të bindshme që mund të shpjegojnë se këto plaka pergamene janë paraqitur gjatë transportimit të trupit, gjatë rienimimit ose gjatë një konvulsioni. Në fakt, nuk kemi të bëjmë me zona të kapjes ose mbajtjes (në rastin e transportit), zona e intervenimit mjekësor në emergjencë (në rastin e reanimacionit) as zona të dala të trupit të cilat do të ishin përplasur kundër pengesave në rastin e transportit dhe të konvulsionit. Edhe pse nuk aq specifike, ky lloj lëndimi mund të gjendet në rastet e dhunshme ndaj qafës (Saukko end Kinght 2016; Madea 2016). Ollakat pergamene të vendosura në regjionin frontal superior, të regjionit pre-artikular të majtë të faqes anteriore të parakrahut të majtë janë shumë pak specifike ashtu që të mund të shprehemi sa i përket origjinës së tyre të saktë. Edhe pse teorikisht ato mund të shkaktoheshin nga transportimi i trupit, nga manovrat e rianimimit ose nga konvulsionet, as aspekt as lokalizimi i këtyre lëndimeve nuk e evokon njërin nga këto tri mekanizma.

Petechiae e konjunktivat okulare dhe palpebrale (qepallave) janë pasoja e një rritjeje e presionit vaskular në gjirin venule të fytyrës, të njëpasnjëshme në një obstruksion të kthimit venoz nga koka drejt zemrës. Ky lloj lëndimi vërehet shpesh në rastet e kompresionit të qafës ose të toraksit (Madea 2016, Saukko and Knight 2016, Dettmeyer dhe al. 2014, Beauthier 2011). Në rastin e specieve ato mund të shkaktohen nga përpjekjet për të vjellur (Betz, Penning and keil, 1994).

Plagët sipërfaqësore të vëna në pah në nivelin e regjionit latero-cervikal të djathtë dhe të kyçit të majtë janë pasojë e traumave të shkaktuara nga një objekt i mprehtë. Ato përputhen me lëndimet e shkaktuara nga një brisk rroje. Aspekti sipërfaqësor i këtyre lëndimeve dhe karakteri globalisht paralel i tyre mund të çojnë në lëndime të vetë shkaktuara, ashtu siç propozohet nga mjekët ligjorë. Në bazë të videove dhe të fotografive në dispozicion, hemorragjia e jashtme konsekutive e këtyre plagëve ishte i një sasie të dobët dhe jo i natyrë së provokimit të një goditje hemorragjike.

Ecchymosis dhe pllakat e pergamene "në formë" të toraksit kanë një aspekt të lëndimit duke u lidhur me manovrimet e reanimimit (masazhi kardiak i jashtëm dhe defibrilation).[12]

Aspektet e skuquara dhe të rrumbullakëta të palosjes së bërrylit të djathë është provokuar nga një plagë e injektimit, edhe pse rezolucionet e fotografive nuk mundësojnë për ta konfirmuar. Aureola e ecchymosis në periferi shkon në drejtim të kësaj hipoteze. Në këtë rast, ajo është ndjellëse enjë pike të injeksionit.

[12] Një metodë për t'i dhënë zemrës një ritëm normal me një goditje elektrike të fortë, por të shkurtër asinkron.

Dilaserationet e rrënjës së gjuhës dhe i skajit të djathtë të gjuhës janë si pasojë e traumave të shkaktuara nga një objekt i mprehtë ose shpuesit dhe tehut. Mungesa e infiltrimit hemorragjik në periferi dëshmon lëndime të shkaktuara në periudhën past-mortum. Nga lokalizimi dhe simetria e plagëve, ato janë shkaktuar, sipas të gjitha gjasave gjatë nxjerrjes së gjuhës gjatë autopsisë. Për ilustrim, lloji i njëjtë i lëndimit shihet në një pjesë të autopsisë së gjuhës e publikuar në literaturë (Kurhara et al. 1992.) Disa dilaseratione, në lidhje me nxjerrën e gjuhës dhe të faringut në nivel të plagës, janë të një aspekti të ngjashëm dhe shihen në videot dhe fotografitë e autopsisë. Hipoteza e propozuar nga mjekët ligjorë të dihet se dilaceratonet janë provokuar nga një presion i tepërt në gjuhë gjatë një mbylljeje të pjesës së thellë të kavitetit bukal (qiellza e fortë) përballë një objekti të fortë, ne nuk na duket i mundshëm për arsye të mungesës të shenjës së vitalitetit përreth lëndimeve si dhe nga morfologjia e këtyre lëndimeve. Për ndryshe, ne nuk kemi gjetur gjurmë të një mekanizmi në literaturën mjeko-ligjore.

Petechiae subpleural (njollat e Tardieu) mund të shihen në rast të një asfiksie por nuk janë specifike të këtij mekanizmi (Saukko end Kinght 2016).

Fraktura e brinjës së 4[te] të majtë, ka mundur të shkaktohet nga matjet e rianimimit pa e përjashtuar ndonjë mekanizëm tjetër (trauma tjera të hapura).

Zonat e ngjyrimeve kuq-vjollce në mukozë të qiellzës së butë, që evokojnë infiltrime hemorragjike, janë pasojë e traumave të hapura (përplasja e trupit kundër një objekti të hapur, goditur nga një objekt i hapur). Ato mund të jenë me origjinë ndikimit nga fundi i shishes prej plastike përballë mukozës.

Edeme pulmonare hemoragjike akute dhe e përhapur është një konstatim klasik i asfiksisë violente edhe pas patofiziologjia e saj mund të debatohet. Kemi të bëjmë me një shenjë jo specifik.

Bronkoaspiracioni akut dhe i përhapur i materialit ushqimor, në gjirin e rrugëve ajrore, tregon se shishja e plastikës nuk e mbyllte tërësisht hapjen e laringut (aditus larynge) dhe se materiali ushqimore i pranishëm në lukth ka mundur të ngjitet në ezofag, kalon në faring pastaj në laring, në trake pastaj në mushkëri. Vjellët ishin, sipas të gjitha gjasave, në lidhje me stimulimin nga shishja e plastikës i receptorëve të refleksit e pranishme edhe neveria në gojë dhe në faring.

b. Komentimet për shkakun e vdekjes

Në bazë të të gjitha konstatimet dhe ne duke u bazuar mbi të dhënat nga literatura, mund të përfundojmë se vdekja e z. DEHARI Astrit është rezultat e asfiksisë.

Nga një pikëpamje teorike, asfiksia përkufizohet si një ndërprerja e furnizim, i bartjes dhe përdorimit të oksigjenit drejt organeve të trupit (Dettmeyer dhe al. 2014, Saukko and Knight 2016, Spitz 2006). Truri është organi më i ndjeshëm në mungesë të oksigjenit, pra është që më së shpeshti preket i pari. Një kalisifikim i unifikuar i asfiksisë ka qenë propozuar nga A. Sauvageau dhe E. Boghossian (2010) që i ndante asfiksitë në katër grupe:

- grupi i ngulfatjeve (ang "suffocatios") nënkupton:
  - ngufatjen e llojit *smothering* që ka të bëjë me një obstruksion të rrugëve ajrore mbi epiglotë,
  - ngulfatjen e llojit *choking* që ka të bëjë me një obstruksion të rrugëve ajrore nën epiglotë,
  - ngulfatje në hapësirat e mbyllura (sh. Me thes plastike), i llojit varrosjes (sh. Futja e kokës në rërë) ose në atmosfera të ndotura (sh. Helmimi me monoksid të karbonit),
- grupi i bllokimit, që kate bëjë me një asfiksim me mbylljen e enëve të gjakut dhe të rrugëve ajrore në nivelin e qafës n duke u lidhur me një kompresion të jashtëm që nënkupton;
  - me varjes që korrespondon me një shtypje trunore që lidhet me peshën e trupit,
  - me bllokimin përmes litarit që lidhet me një shtypje trunore që lidhet me një forcë tjetër përveç peshës së trupit,
  - me bllokimin manual që lidhet me një shtypje trunore nga njëra apo të dy duart ose me pjesë tjera të gjymtyrëve,
- grupi i asfiksimeve mekanike nënkupton:
  - asfiksimi i pozicional që lidhet me një pozitë të trupit e cila pengon frymëmarrjen,
  - asfiksimi traumatik i shkaktuar me një shtypje mbi toraks me një objekt të rëndë ose nga një person,
- grupi i fundosjes në ujë.

Zvogëlimi ose ndërprerja e tërësishme e sjelljes së gjakut të oksigjenuar në tru shkakton një humbje të vetëdijes dhe një të tonusit muskulor. Kjo humbje e tonusit muskulor i bën të pamundura të gjitha manovrimet e vetë-ngulfatjes manuale ose me litar. Në veçanti kjo bën të pamundur vetë-ngulfatjen duke mbajtur një objekt në rrugët ajrore. Një vetë-ngulfatje duke mbajtur një objekt në mënyrë pasive në rrugët e ajrit (sh. Vendosja e një leckë) mbetet gjithnjë e mundshme.

→

# ASTIN E VDEKJES SË ASTRIT DEHARIT

Diagnoza e asfiksimit në rastin e z. DEHARI Astrit mbështetet në praninë e shenjave "klasike" të asfiksimit (Madea 2016; Saukko and Knigh 2016), edhe pse këto të fundit mund të jenë jo shumë specifike (Saukko and Knigh 2016), siç dihet prania e petechies (pikës lëkurore ngjyrë e kuqe në vjollce) konjunktivale bilaterale, petechies subpleurale (njollë e Tardieu), të një edeme pulmonare hemorragjike akute dhe e një kongjestion pulmonar.

Sa i përket mekanizmit të asfiksisë në rastin e z. DEHARI Astrit, kemi të bëjmë saktësisht me një mekanizëm me ngulfatje të llojit *smothering* (Sauva geau and Boghossian 2010) me një objekt me përbërje të fortë (një shishe plastike). Siç është përshkruar më lartë, ngulfataja e llojit *smothering* është përkufizuar si obstruksion i rrugëve ajrore mbi epiglotë, në këtë rast për shkak të një shisheje prej plastike që mbyllë rrugët ajrore në nivelin e gojës dhe të faringut. Ka të ngjarë që prania e infiltrimeve hemorragjike të vendosura në nivelin e qiellzës së butë shkon në drejtim të kësaj diagnoze. Që të rikujtojmë, rrugët ajrore përbëhen, nga lartë poshtë, me zgavrat nazale, me zgavrat orale, me faringun, me trakenë, me bronket dhe mushkëritë. Epiglota është një strukturë anatomike që mundëson të ndajë faringun dhe laringun. Në rastin e z. DEHARI, shishja është gjetur e futur në gojë nga fundi, baza e saj që ka madhësi prej 6cm të diametrit. Matjet anatomike të laringur të kryera nga Eckel dhe al. (1994) mundësojnë të vlerësohet se diametri normal i vrimës së laringut (aditus) është mesatarisht 3,82cm (minimum 27mm dhe maksimumi 63mm) tek njeriu. Sa i përket asaj se kjo matje bazohet mbi distancën në mes të strukturave të kartilagut (kërcit) të cilat e kufizojnë vrimën e laringut (briri i sipërm i kërcit tiroide), kjo vlerë është e mbivlerësuar sepse ajo nuk nënkupton indet e buta të cilët mbulojnë strukturat e kartilagut (kërcit). Baza e shishes prej plastike do të duhet të gjendej mbi epiglotë. Një argument tjetër që shkon në këtë drejtim të konstatimit është prania e madhe bronkoaspiracionit të materieve ushqimore. Në fakt, në mënyrë që një bronkoaspiracion i tillë të ndodh, është e nevojshme që drita e laringut të jetë e lirë. Në këtë lloj mekanizmi, disa njolla të izoluara mund të shihen në nivelin e konjunktivave (Madea 2916), çfarë ishte rasti i z. DEHARI Astrit.

Prandaj, një kombinim me mekanizmat tjerë nuk mund të përjashtohet. Në fakt, gjatë autopsisë e z. DEHARI Astrit, lëndimet në regjionin cervikal ishin të dukshme (ecchymosis[13]në nivelin e këndit të mandibulës së djathtë dhe të skajit antero-inferior të djathtë të mandibulës, pllaka pergamene në pjesën laterale të djathtë të qafës, me madhësi dhe formë të ndryshme, disa nga të cilat në formë harku).

Raporti i autopsisë tregon, se mekanizmi potencial i vdekjes, është një ndërprerje reflekse të aktivitetit kardiak i shkaktuar nga shishja e vendosur në gojë. Ky mekanizëm i vdekjes është i njohur nën emrin "bolus death" në literaturën shkencore. Kjo përcaktohet si një vdekje e shkaktuar nga një obstruksion i laringut ose i pjesëve inferiore të faringut, e shoqëruar me një ndërprerje kardiake reflekse (Madea 2016). Nuk kemi të bëjmë me një vdekje me asfiksi. Prania e shenjave të asfiksisë, mungesa e obstruksionit të laringut ose të pjesëve inferiore të faringut si dhe konstatimet e një pulsi dhe të një frymëmarrjeje të bëra nga infermierja e qendrës së paraburgimit të Prizrenit (anëtarja e parë e personelit mjekësor që e ka ekzaminuar z. DEHARI),

[13] Zhvendosja e indit socio-lëkuror pas një tronditjeje, ku paraqiten njolla të kaltra.

mundësojnë të përjashtohet vdekja me ndërprerje reflekse të aktivitetit kardiak ("bolus death"), ashtu siç është thënë në raport të autopsisë.

e.Komentet për rrethanat e vdekjes

Në bazë të të gjitha këtyre konstatimeve dhe ne duke u bazuar mbi të dhënat e literaturës, ne mundë të bëjmë komentimet e mëposhtme:

- Në hipotezën e shkaktimit të vetëvrasjeje, kemi të bëjmë me një vetëvrasje komplekse të paplanifikuar. Në literaturën mjeko-ligjore (Germerott et al. 2010), është bërë një dallim në mes vetëvrasjes së thjeshtë dhe vetëvrasjes komplekse, e para përdor vetëm një metodë ndërsa e dyta përdorë shumë metoda. Sipas të dhënave të literaturës, vetëvrasjet komplekse janë përshkruar në 1,5 deri në 5% në të gjitha vetëvrasjet dhe implikojnë shpesh individë me sëmundje psikiatrike sikur që janë çrregullimet e personalitetit, depresioni ose skizofrenia (Germerott et al. 2010). Vetëvrasja komplekse mund të ndahet në "të planifikuar" ose "të paplanifikuar" në funksion të përdorimit të njëkohshëm ose skuenciale të metodave respektive. Në vetëvrasjet komplekse të paplanifikuara, mortaliteti i metodës së parë është i dobët në të shumtën e rasteve dhe për shkak të dhimbjes dhe të frustrimit për dështimin e metodës së parë, një metodë shtesë më shkatërruese është përdorur (Germerott et al. 2010). Në rastin e z.DEHARI, nëse e pranojmë hipotezën e vetëvrasjes, të dy metodat do të ishin përdorur në mënyrë sekuenciale, e para ka të bëjë me përdorimin e një objekti të mprehtë në pjesën e qafës dhe të kyçit të majtë dhe e dyta ka të bëjë me ngulfatjen e llojit *smithering* me një sheshe të plastikës. Megjithatë, kjo hipotezë duket pak e mundshme për arsyet e më poshtme: së pari lëndimet cervikale dhe të kyçit ishin shumë sipërfaqësore, që nuk tregonin përcaktime të vërteta të aktit vetëvrasës; e dyta, teoria e vetëvrasjeve komplekse të paplanifikuara që ka dëshiruar z. DEHARI, duke parë këtë tentativë të pasuksesshme, e zgjedh metodën e dytë të vetëvrasjes më vdekjeprurëse, çfarë nuk ishte rasti. Në fakt ai është kthyer drejt një ngulfatjeje të vetë-shkaktuar, një metodë komplekse, efikasiteti i dobët është shumë i rrallë (kjo lloj ngulfatjeje verëvrasëse është përshkruar në literatur vetëm në raste të rralla); si e tretë, kjo lloj vetëvrasjeje kryesisht haset tek pacientët psikiatrikë pra që z. DEHARI nuk paraqiste asnjë paraardhje psikiatrike dhe nuk paraqiste shenja të depresionit. Ndër të tjera sipas njohurive tona, kurrë nuk është përshkruar, në literaturë, vetëvrasja komplekse që implikon një ngulfatje të llojit *smithering* e paraprirë nga përdorimi i një objekti të mprehtë.

- Në literaturë ne kami hasur vetëm dy raste të përdorimit të ngulfatles së llojit *smithering* si mënyrë e vetëvrasjes (Di Vella et al. 2002 ; Viero et al. 2016). Në rastin e parë, kemi të bëjmë me vendosjen e ngjitsit rreth kokës, që i bllokonte rrugët respiratorë (Di Vella et al. 2002). Në rastin e dytë kemi të bënim me një futje të peshqirit dhe të dorezave prej kauçuku dhe qumështit në rrugët ajrore, mbi epiglotë. Në këtë rastin e fundit vërejmë se kemi të bëjmë me karakteristika të objekteve të futura ( dhe në veçanti poroziteti i peshqirëve të cilët që futen në mukoza) që e bënte të pamundur hapësirën spontane të rrugëve ajrore thjeshtë me rrëshqitjen e materialit të përdorur. Në rastin e z. DEHARI Astrit, nëse e pranojmë hipotezën e vetëvrasjes, pasi që ka vendosur shishen hipotetike në gjirin e gojës dhe e ka mbajtur aktivisht vetë viktima këtë të fundit, një fazë e humbjes së vetëdijes do të paraqitet për shkak të hipoksisë cerebrale, konsekutive në obstruksionin e stërzgjatur të rrugëve ajrore. Në këtë moment, tonusi muskulor do të lëshohet dhe duart nuk do të mund të mbanin shishen. Në faktin se shishja është plastike dhe me skaje të lëmuara, e rrumbullakët dhe pa rrethe, kjo nuk do të ishte e mundur të qëndronte e ngulitur në faring në mënyrë të një obstruksioni të tërësishëm. Një skenar eventual i mudnshëm (por jo i përcaktuar nga DiMiao dhe DiMiao) do të ishte që viktima të shtrihet në bark dhe kur ta humb vetëdijen, shishja e përqendruar në mes kokës dhe tokës vazhdon në mënyrë efikase të mbyllë rrugët ajrore. Kemi të bëjmë me një eventualitet shumë të pamundur, pasi që duhet të kemi parasysh gjithashtu, se gjatë fazës së futjes që karakterizon asfiksinë, lëvizjet e trupit do ta pengojnë ruajtjen e kësaj pozite, me rrëshqitjen e shishes dhe lirimin e rrugëve ajrore. Megjithatë duhet të nënvizojmë se skenari i fundit i komentuar nuk mund të merret parasysh në rastin e z. DEHARI sepse trupi i tij është gjetur në dekumitus dorsal, ashtu siç dëshmohet nga të gjithë dëshmitarët.

- Rastet tjera të vetëvrasjeve me ngulfatje që implikojnë objekte në rrugët ajrore janë përshkruar në literaturë (Germerott et al. 2010; Morgan et al. 2010; Saint-Martin et al. 2007; Sauvageau et al. 2006; Saukko and Knigh 2016), por konsistonin në ngulfatjet e llojit *choking*, duke mbyllur rrugët ajrore nëm epiglotë (pluhur talcum, sumac helmues, peshqirë, letër gazetash, poliuretan të ndërtimit, plastikë, falkon medikamentesh). Në këto raste, viktimat ishin shpesh të njohura me çrregullime psikiatrike. Për të rikujtuar z. DEHARI Astrit nuk vuante nga çrregullimet mendore dhe në rastin e tij shishja gjendje mbi epiglotë.

- Ngulfatja e llojit *Smothering* në rastet e vrasjeve, ka të bëjë me një material të futur në rrugët ajrore që janë përshkruar nga literatura (nga sh. Boghossian et al. 2010 (2 raste); Kurihara et al. 1992; Saint-Martin et al. 2012. Në rastin e Kuriharas et al. (1992), obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në nivelin e laringo-faringut me ndihmën e peshqirëve letër. Ekzaminimi në veçanti ka zbuluar praninë e pikave konjunktive, plagë dhe gërvishtjeve në nivelin e qafës. Në rastine Saint-Martin et al. (2012) obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në nivelin e laringo-faringut me ndihmën e letrës së tualetit. Në këtë rast, ekzaminimi i jashtëm zbuloi lëndime në nivelin e qafës dhe të fytyrës (ecchymosis) dhe në parakrah (ecchymosis) dhe gërvishtje. Në serinë e rasteve të Boghossian et al. (2010) obstruksioni i rrugëve ajrore ishte kryer në një rast me kravatë dhe në dy rastet tjera me doreza. Sipas Boghossian et al. (2010) dhe të DiMaio and DiMaio (2001), vrasje me ngulfatje të llojit *Smothering* është shumë e vështirë mbi një të rritur duke pasur parasysh aftësitë e tij.

- Në rastin e z. DEHARI Astrit, autopsia ka zbuluar praninë e lëndimeve të shtypura në nivelin e regjionit frontal superior, të pjesës inferiore të fytyrës së djathtë, të pjesës laterale të djathtë të qafës, të parakrahut të djathtë dhe të dorës së djathtë. Këto lëndime nuk mund të shpjegohen me një veprim vetëvrasës me armë të mprehtë dhe ngulfatje. Hipoteza e lëndimeve të shkaktuara nga transporti i trupit, nuk i shpjegojnë në tërësi këto konstatime dhe nuk ngjajnë shumë bindëse.

Vijon në numrin e ardhshëm

Në 30-vjetorin e rënies së Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut (3)

# Vërsulja serbe mbi Kosovën dhe reagimi popullor



Shkruan: Mehmet HAJRIZI

**8.** Transformimet demokratike në rajon, nuk patën asnjë efekt pozitiv për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi, sepse regjimi kriminal i Slobodan Milosheviqi, u vërsul me të gjitha mjetet për ta suprimuar edhe atë autonomi që e kishte Kosova dhe vendosi aty masa të dhunshme në çdo fushë të jetës, duke përjashtuar popullsinë shumicë shqiptare nga jeta politike, ekonomike, arsimore, kulturore, informative etj. Për pasojë, popullsia shqiptare u ndodh në një gjendje edhe më të rëndë dhe më të padurueshme.
Afrim Zhitia me penën e tij të mprehtë, do të shkruajë: "Dhe në fund mendojmë dhe jemi të bindur se reaksioni serbomadh nuk ka ku të shkojë më tej nga hapja e zjarrit kundër masave popullore shqiptare liridashëse. Lufta jonë e drejtë nacionalçlirimtare ka ku të shkojë më tej-drejt fitores, e cila gjithnjë e më tepër po bëhet e domosdoshme dhe kjo do të vijë patjetër.[1] Në një tjetër shkrim ai, duke analizuar demonstratat e nëntorit të vitit 1988, i parashikon në mënyrë profetike zhvillimet e ardhshme në Kosovën e tij: "Kosova ka hyrë tashmë në një lëvizje të re e vendimtare për fatin e vet, zhvillimet e së cilës nuk do të ndalen dot derisa të mos arrihet liria".[2]

**9.** Nga fillimi i vitit 1989 në Kosovë zhvillohej një diskutim publik farsë, për ndryshimet kushtetuese me qëllim të heqjes së autonomisë. LKSH dhe qytetarët e Kosovës i kundërshtuan ndryshimet në mijëra mbledhje dhe protesta, në të cilat morën pjesë rreth gjysmë milioni njerëz. Do përmendur në mënyrë të veçantë protestën e mbi 1.300 minatorëve të Trepçës, më 1989, kur me vetëmohim u mbyllën në horizontet e thella të minierës në Stan Tërg, me të cilët u solidarizua i tërë populli shqiptar dhe sidomos studentët e Universitetit të Prishtinës. Bashkë me studentët dhe profesorët, në sallën e grevës, ishin edhe Fahri Fazliu dhe Afrim Zhitia. Lëvizja ilegale kombëtare e Kosovës, ndonëse e goditur rëndë dhe sistematikisht nga regjimi, ishte aktive dhe e fuqishme me organizimin e saj jashtë e brenda atdheut. Ajo i organizonte dhe u printe masave në rezistencën kundër pushtuesit. Regjimi ndërkaq, me aparatin shtypës ndërmori masa të egra dhe të përgjakshme për të shuar revoltën e popullit të pakënaqur të Kosovës, duke krijuar kushtet që udhëheqja serbe, më 23 mars 1989, në Kuvendin e Kosovës dhe, pesë ditë më vonë, në Kuvendin e Serbisë, ta suprimonte autonominë e Kosovës.
Më vonë Afrim Zhitia, duke analizuar kontekstin historik, në shkrimin e tij Lufta e popullit tonë është e drejtë, fushata antishqiptare nuk mund ta devijojë atë, midis tjerash thotë: "Ende na janë të freskëta kujtimet për skenat rrëqethëse të datës 23 të muajit mars, kur masakrimi i popullit liridashës shqiptar nga ana e barbarëve serbomëdhenj tronditi botën. Vrasja e plagosja e dhjetëra e qindra demonstruesve paqësorë, duke përfshirë edhe fëmijët e mitur..., përdorimi i tërë makinerisë ushtarako-policore ndaj popullit shqiptar - 'fajtor' sepse kërkon liri - janë treguesit më besnikë për atë se kush ndaj kujt po bën gjenocid në Kosovë, janë dëshmi për atë se sa gëzojnë liri shqiptarët në tokën e vet. Shtypja kombëtare, shovinizmi, histeria nacionaliste kurrë nuk e kanë treguar egërsinë e tyre kaq lakuriqe sa në Jugosllavi gjatë muajve shkurt - maj 1989. Pamjet rrëqethëse tregonin se kërbaçi policor, tanket dhe ushtria siguruan aprovimin e amendamenteve të Kushtetutës së Serbisë, prandaj populli sot me të drejtë Kushtetutën e 're' e quan 'Kushtetutë e tankeve', antishqiptare e antinjerëzore"[3]

**10.** Për mbrojtjen e Kosovës një popull i tërë u ngrit në këmbë, i udhëhequr nga bijat dhe bijtë më të mirë, siç ishin Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Në ditën e suprimimit të autonomisë në demonstratë regjimi i Milosheviqit vrau 29 shqiptarë.[4] Deri në fund të prillit numri i të vrarëve arriti në 100.[5]
Shqipëria që kishte qenë në vazhdimësi mbështetëse e LKSH dhe mbrojtëse e të drejtave të shqiptarëve përtej kufijve të saj shtetërorë, gjatë viteve tetëdhjetë i intensifikoi dukshëm ato. Ndonëse edhe vetë e rrezikuar nga pretendimet e huaja pushtuese, me pozitën e saj të brishtë ndërkombëtare, me fuqinë politike, ekonomike, ushtarake dhe diplomatike që kishte, nuk mund të bënte shumë për Kosovën. Megjithatë mbështetja që ajo i dha Kosovës më 1981, e kalonte dukshëm intensitetin e deriatëhershëm.
Sipas dëshmisë së ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, Shqipëria kishte hartuar Planin ushtarak "Shpërthimi" për ndërhyrje në Kosovë, me qëllim të çlirimit të saj.[6] Për këtë qëllim, fill pas kryengritjes shqiptare të vitit 1981, Shqipëria kishte bërë ristrukturimin e Forcave të Armatosura, duke u dhënë funksionin shtesë të mësymjes, në rast se kryengritja në Kosovë merrte karakter të armatosur, ose në rast të shkallëzimit të dhunës mbi shqiptarët në Jugosllavi.[7]
Studiues të ndryshëm kanë vlerësuar se më 1981 Shqipëria bëri kapërcimin e madh cilësor nga përparësia e ideologjisë në atë të interesit kombëtar. Jens Reuter, në librin e tij "Shqiptarët në Jugosllavi, Studim historiko-analitik", thotë: Nga Kongresi i Tetë i PPSH më 1981, Shqipëria intensifikoi mbështetjen ndaj çështjes së Kosovës."
Ramiz Alia, në cilësinë e presidentit të Shqipërisë në Sesionin e 44-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dënoi dhunën dhe terrorin në Kosovë.[8]

**11.** Me humbjen e subjektivitetit politik e ekonomik dhe nën veprimet shtypëse e shfrytëzuese serbe, në Kosovë u shkatërrua i tërë sistemi ekonomik që çoi në varfërim të skajshëm të rreth 60 për qind të popullsisë. Që nga viti 1989, ekonomia e Kosovës pati normë negative të ecurisë së prodhimit shoqëror prej -7.2%, dhe të ardhurave kombëtare prej -7.4%., të cilat shumë shpejt ranë në rreth 400 dollarë për kokë banori. Instalimi i administrimit të dhunshëm serb mbi institucionet publike dhe ndërmarrjet e Kosovës, rezultoi me dëbimin nga puna të rreth 150.000 punonjësve shqiptarë dhe me rritjen e shkallës së papunësisë mbi 70 për qind. Si pasojë e mjerimit social, por edhe e përndjekjeve policore e ushtarake dhe e terrorit shtetëror, nga Kosova filloi një fluks i paparë deri atëherë i emigrimeve jashtë vendit, që përbënte rrezik serioz për të ardhmen e Kosovës, për më tepër që qindra mijë të ikur ishin kryesisht të moshës së re. Jugosllavia po vlonte nga kontradiktat e vjetra e të reja, derisa shpërthyen luftërat dhe u shemb Federata në pellgun e gjakut të popujve të saj. Populli shqiptar i Kosovës, jo vetëm ndiqej, vritej e torturohej, por edhe ishte dënuar me zi buke nga regjimi pushtues i Milosheviqit famëkeq. **(Vijon)**

---

*1 Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f. 207.*
*2 Hajdin Abazi, Afrim Zhitia-hero i lirisë, botuar te gazeta "Epoka e re", 4 nëntor 2003, f. 9 dhe në librin, Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f. 257.*
*3 Adem Gashi, a-ZH Vetëtimat e Nëntorit, Prishtinë, 2005 f.193-194.*
*4 Feriz Hoti, Shqipëria dhe shqiptarët në arkivat dhe shtypin gjerman, Nurnberg 1996, f. 118.*
*5 Noel Malcom, Kosova një histori e shkurtër, Koha, Botimi i tretë, Prishtinë, 2011 f. 431*
*6 Veli Llakaj, Tetë vjet në krye të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, Tiranë, 2006*
*7 Dilaver Goxhaj, Forcat e Armatosura Shqiptare në prag, gjatë dhe pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, botuar te përmbledhja Lëvizja, themelimi i Lëvizjes dhe heronjtë e janarit 1982, Prishtinë, 2017, f. 80.*
*8 Sejdi Gega dhe Fazli Veliu, LPK në vazhdën e përpjekjeve për bashkim, themeluese e UÇK, pjesa I, ArbëriaDesign, Tetovë, 2018, f. 137*




MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100% mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA

E rrallë

# Banda afrikane që po shqetëson suedezët



Një bandë kriminale me origjinë nga Nigeria, sipas policisë, po vazhdon të përhapet nëpër qytetet suedeze. Grupi merret me trafik njerëzish nga Nigeria, me shpërndarje droge dhe thuhet se përdor kërcënime me magji të zezë afrikane ndaj emigrantëve që sjellin për t'i detyruar të kryejnë krime. "Sëpata e Zezë" thuhet se është një "kult vdekjeje" që i zgjidh problemet e brendshme me hanxharë dhe rrëmbime dhe që po përhapet nëpër Suedi në mënyrë të frikshme.

FOTO E DITES



Gjendje e mjerueshme e Liqenit të Përlepnicës në Gjilan. /ER/

E jashtëzakonshme

# Pema më e vjetër në Evropë vazhdon të rritet edhe sot



Pema më e vjetër në Evropë, edhe pse është 1 230-vjeçare, po vazhdon të rritet edhe sot. Ekspertët e kanë quajtur "Italus", pasi e zbuluan në vitin 2017, në Parkun Kombëtar të Polinos, në Kalabri, Itali. Mosha e pishës "loricato" u gjet nga shkencëtarët nëpërmjet vlerësimit të gjurmëve të karbonit. Pema rritet mbi një faqe shkëmbi e cila jo vetëm se e ka mbrojtur trungun dhe degët nga flakët dhe rrufetë, por ka ruajtur edhe temperaturën e ulët.

## BARSOLETA E DITËS



**Rrugë e gjatë, nxehtë i madh, para tyre ndodhet një pemë dhe ata bashkë vendosin të ulen nën të. Pas një kohe gruaja çon kokën lart, sheh dy zogj sqep me sqep dhe i thotë të shoqit:**
**- More burrë, çfarë po bëjnë ata zogj atje lart?**
**- Po puthen.**
**- Po pse nuk më puth edhe ti mua?**
**- Po kush dreqin hip atje lart!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetem gjatë vikendit në ora 14:00**

## ABOMINABLE 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton

**Çdo ditë në ora 16:00**

## TOY STORY 4 / 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

**Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00**

## MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D




Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning

**Çdo ditë në ora 22:00**

## ZOMBIELAND DOUBLE TAP




Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Do të vini në zbatim gjithçka që keni mësuar gjatë këtyre ditëve. Sot ju nevojiten patjetër për ta zgjidhur një situatë ngërçi.



**DEMI**
Nëse nuk dëshironi të keni kundërshtime nga të gjithë sot, mundohuni të shpjegoheni sa më qartë për gjërat dhe detyrat që ju kërkojnë.



**BINJAKËT**
Ka disa rrugë ku ju mund të shkëlqeni në karrierën tuaj personale, por ka rrugë të tjera të cilat mund të bëjnë persona afër jush të triumfojnë.



**GAFORRJA**
Disa argumente të caktuara sot mund të sjellin debate të ndezura në familje. Është mirë që çdo pjesëtar ta dëgjojë tjetrin përpara se të flasë.



**LUANI**
Keni përballuar shumë sfida kohët e fundit dhe kjo ju ka dhënë mjaft vetëbesim. Mundohuni që në çdo fushë të jeni në të njëjtën frymë.



**VIRGJËRESHA**
Një situate emergjente dhe që e kishit neglizhuar sot do t'ju shtrëngojë të rrini shumë më gjatë në punë. Nuk jeni të sigurt nëse do ta zgjidhni.



**PESHORJA**
Dita do të nisë qetë, por disa të papritura do të ndryshojnë të gjithë rrjedhën e saj duke ju detyruar të anuloni disa plane tuajat.



**AKREPI**
Keni marrë përsipër disa aktivitete të pazakonta për ditën e sotme dhe do të shikoni që mund të jetë pak problem për t'i finalizuar.



**SHIGJETARI**
Nuk po merrni vendimin më të lehtë nga ana sentimentale, por do t'i bëni shumë mirë një personi të afërt me ju.



**BRICJAPI**
Nëse sot nuk ju pëlqen të debatoni lidhur me një problem të caktuar, keni gjithë të drejtën të tërhiqeni dhe të tregoheni indiferent.



**UJORI**
Rreth jush janë krijuar pritshmëri të caktuara sepse keni treguar që mund t'i realizoni dhe të bashkëpunoni në kohë rekord për gjëra të ndryshme.



**PESHQIT**
Ditët e fundit jeni në pritje të një lajmi të rëndësishëm që do të arrijë vetëm sot. Edhe pse do të zhgënjeheni pak do të rikuperoni rrugës.

# Ed Sheeran i famshmi më i pasur në Britani, dyfishoi pasurinë për një vit



Ed Sheeran është klasifikuar si personi i famshëm më i pasur në Britani nën moshën 30 vjeç. Këngëtari pothuajse dyfishoi pasurinë e vet brenda një viti. 28-vjeçari u vlerësua në vitin 2018 se kishte një pasuri me vlerë 94 milionë dollarë. Ndërsa këtë vit, sipas listës së re të revistës "Heat", pasuria e tij u vlerësua 170 milionë dollarë. Ed Sheeran rrëzoi nga froni Adelen, e cila mbushi 31 vjeç në maj. Pjesa më e madhe e të ardhurave të Ed raportohet se vjen nga turneu i tij në botë "Divide", që i siguroi 599.4 milionë paund fitime.

# Taylor Swifti nderohet me çmimin prestigjioz "Artistja e dekadës" në AMAs 2019



Taylor Swifti është vlerësuar me një çmim mjaft të madh. Këngëtarja me famë botërore do ta marrë çmimin "Artistja e Dekadës" në American Music Awards 2019 muajin e ardhshëm. Lajmi u bë me dije nga producentët e shfaqjes Dick Clark Productions. Ajo, gjithashtu, pritet të performojë disa nga hitet përgjatë karrierës në muzikë.



# Simon Cowell me familjen në përgatitjet finale për Halloween

Producenti i njohur televiziv Simon Cowell ditë më parë anuloi papritur festën e ditëlindjes së 60 për shkak se ai ishte caktuar për të qenë nikoqir i një feste ekskluzive në një restorant në Londrën perëndimore. Megjithatë, Simon Cowell u shfaq me shpirt të mirë ndërsa ndau kohë me partneren Lauren Silverman dhe djalin Eric. Familja u bashkua për ta përgatitur shtëpinë e tyre në Londër për ta shënuar festën e Halloweenit.

# Dua Lipa dhe Rita Ora në listën e më të pasurve



Dy këngëtaret me origjinë shqiptare, Dua Lipa dhe Rita Ora, kanë hyrë në listën e më të pasurve në Britani. Lista e personazheve të famshëm më të pasur nën moshën 30 vjeç u publikua nga revista "Heat". Dua Lipa mban vendin e 15-të me një pasuri me vlerë 11.8 milionë paund. Revista shkruan se Dua Lipa rriti të ardhurat me 9 milionë paund që nga viti 2018 për shkak të kontratave me "Jaguar", "Adidas", "Pepe Jeans" dhe "YSL". Ndërkohë Rita Ora mban vendin e 13 me pasuri 17.8 milionë paund. Por, revista shkruan se të ardhurat e saj nuk kanë ardhur nga muzika, por nga marrëveshjet mjaft fitimprurëse me markat e famshme si "Adida" dhe "Cola Cola".

# Familja Sorgo - aristokracia

Nga: Salajdin SALIHU

Lidhjet e shqiptarëve me Dubrovnikun kanë qenë të moçme. Aty kanë vepruar personalitete shqiptare nga bota kulturore, shkencore apo klerikale. Dubrovniku, historikisht, ka pasur këmbime tregtare me qytetet e ndryshme shqiptare. Në këtë qytet është shquar familja fisnike me origjinë shqiptare, Sorgo. Nga gjiri i saj kanë dalë kompozitorë, poetë, intelektualë, politikanë e diplomatë. Pavarësisht prej faktit se kjo familje kishte lidhje të shumta me botën kulturore evropiane, ajo është pothuajse e panjohur për botën shqiptare.

### Shqiptarët dhe Dubrovniku

Dubrovnik, 14 korrik 1285.[1] Njëfarë Mateu, i biri i Markut, dëshmonte për një grabitje. Ai kishte dëgjuar se si grabitësit flisnin shqip: *Dëgjova në zë që thërriste në mal në gjuhën shqipe (Auditivi unam vocem clamantem in monte in lingua albanesca).*[2] Mateu dhe hajnat i bënë shërbim historisë shqiptare, sepse kjo është dëshmia e parë për gjuhën shqipe.

Lidhjet e shqiptarëve me Dubrovnikun (Raguzën) janë të moçme. Më 1208 fisniku shqiptar Dhimitër Progoni kishte lidhur marrëveshje tregtare me Republikën e Raguzës. Marrëveshja qe publikuar edhe nga profesori i Beogradit, A. Soloviev.

Shpanët (dega e Shkodrës) përmendën si qytetarë të Dubrovnikut që nga viti 1380. Besohet se aty ishin vendosur në vitin 1322 dhe vepruan deri në mesin e shekullit XVII.[3]

Në Dubrovnikun e shekullit XIV kemi 13 familje të pasura nga Shqipëria, që ishin pakësuar dukshëm në shekullin e XIX.[4]

Familje fisnike të Dubrovnikut me origjinë të largët shqiptare, sipas studiuesve, ishin edhe: Bona (Bunic), Giorgi (ose Gjurgjevic, Zorzi, Georgi, Giorgi), Cerva (Crijevic), Kaboga (Kabuzic, Caboga), Sorgo (Sorgocevic, Sorkocevic), Saraca (Saracic), Pesta (Pestic), Bobali (Bobaljevic), Pozzo (Pucic) etj.

Kur Republika e Raguzës e fitoi pavarësinë nga Venediku më 1358, kryetar i parë i saj ishte Nicola de Sorgo (Niksha Sorko cevic).

Ndre Durrësaku, një argjipeshkëv i Raguzës në periudhën 1387- 1393, sikurse shkruan Jahja Drançolli, pasi e rregulloi çështjen e kishës në Raguzë dhe më gjerë, më 1386 u shpall provincial (drejtues) i Provincës së Dalmacisë, i treti që nga themelimi i saj.[5]

Në Dubrovnik e gjejmë letrën, në latinisht, të vitit 1403, nga princi arbëror Nikolla Topia, i cili, sipas Edit Durhamit, shkruante se shqiptarët ishin kundër Bosnjës *(Ua jap autorizimin tim mbikapedanët me Gjuragjevìqin dhe shqiptarët e tjerë)*, ndërkaq më 1404 përmendet edhe Zernoviqi i quajturi Giurazy, që është me origjinë nga Guri-i-zi.[6]

Këtu veproi humanisti shqiptar Gjin Gazuli (1400-1465), matematikan, astronom dhe ambasador i Skënderbeut në Dubrovnik apo Pal Gazuli (1405-1470), bashkëpunëtor i Skënderbeut, i emëruar më 1442 rektor i shkollave të Raguzës. Ai jetoi dhe vdiq në Dubrovnik.

*Më 1461 ishte për vizitë katërditore në Dubrovnik edhe Skënderbeu së bashku me këshilltarin, Pal Engjëllin. Dokumentet e shumta dëshmojnë për raportet e mira të tij me Republikën e Raguzës.*[7]

Historia ka shënuar valë migrimesh të shqiptarëve, veçmas drejt qyteteve dalmate. Në shekujt XIV-XV shqiptarët ishin vendosur edhe në Dubrovnik. Klerikët shqiptarë, madje, kishin krijuar shkolla (scuola) ose vëllazëri shqiptare (confraternitas) në qytetet dalmate.

Për veprimtarinë e klerikëve shqiptarë në Dubrovnik ekzistojnë shumë dokumente me vlerë nëpër arkivat e Dubrovnikut. Një studim me vlerë është ai i Etleva Lalës me titull *Klerikët shqiptarë të mesjetës në arkivat e Dubrovnikut.* Aty jepen të dhëna për klerikë shqiptarë që kishin arritur në pozita ipeshkvësh dhe kryeipeshkvësh jo vetëm në Dubrovnik, por edhe në qytete të tjera dalmate.

Ndërmjet Dubrovnikut dhe qyteteve shqiptare, sikurse Durrësi, Vlora, Berati, Shkodra etj., pati shkëmbime të shumta tregtare.

Gjatë kohës së urisë së madhe Dubrovniku importonte grurë nga Shqipëria. Në shekujt XIII dhe XIV, në Durrës dhe në Vlorë, kishte koloni qytetarësh raguzianë.

Më 1319 përmendet Halil Durrësaku (Draçanini) që bënte tregti me Dubrovnikun.

Më 1360 dhe 1361 flitet për tregti shumë të zhvilluar ndërmjet Vlorës dhe Dubrovnikut, madje tregtarët e të dy vendeve nuk paguanin as taksa doganore.

Më 1387 Lekë Dukagjini u bënte thirrje tregtarëve nga Dubrovniku të mos kishin frikë për të bërë tregti me vendin e tij.

Dubrovniku importonte grurë edhe nga viset e Gjergj Kastriotit dhe kishte këmbime tregtare me Karl Topinë.

Më 20 maj 1697, njëfarë Danil Dolfini, sillte mall nga Holanda në Durrës nëpërmjet Ankonës.[8]

Pero Çingrija (Pero Cingrija, 1837-1921) konsiderohet ndër politikanët më të mëdhenj dubrovnikas dhe dalmat. Ai ishte prefekti më i popullarizuar dhe më jetëgjatë në historinë e Dubrovnikut – nga viti 1878 deri më 1882, pastaj nga viti 1899 deri më 1911. Çmohej për kulturën e tij të madhe. Ishte anëtar i Partisë Popullore. U çmua si politikan i aftë, i drejtë dhe mjaft i popullarizuar.

Çingrija lindi në Dubrovnik më 1838, në një familje të vjetër nga Dubrovniku. Në numrin 11 të gazetës Nase pravice, të vitit 1906, shkruhet: *Familja Çingrija me origjinë është shqiptare, e ardhur në Dubrovnik në kohët e hershme.*



*Mbasepikërisht prej origjinës së vet nga populli i zjarrtë dhe trim, Çingrija duhet t 'ijetë mirënjohëspër energjinë dhe pathyeshmërinë e tij, që e dinë tëgjithë ata që e njohin.*

Në Dubrovnik u shqua edhe familja fisnike Sorgo, e cila pothuajse nuk përmendet nga studiuesit shqiptarë. Duke u nisur nga ky shkak, do të japim disa të dhëna për Sorgot.

### Gjenealogjia

Familja fisnike Sorgo e Dubrovnikut përmendët nga shekulli XTTT. Të parët e saj kishin ardhur aty, së paku, një shekull më përpara. Si familje fisnike ajo kishte stemën dhe flamurin e vet. Në shekullin e XVTTT u quajt Aristokracia Muzikore e Raguzës për shkak të kompozitorëve Luka, birit të tij Antunit dhe Elenës, të cilët krijuan vepra të çmuara të muzikës klasike.

Sorgot i dhanë Dubrovnikut diplomatë, dijetarë, kompozitorë, shkrimtarë, arkitektë. Tshin edhe mecenë të shumë personaliteteve të shquara nga bota e artit dhe shkencës. Jeta politike, ekonomike, arsimore e kulturore e Dubrovnikut përherë ka qenë e lidhur ngushtë me familjen Sorgo. Për origjinën e saj shqiptare flasin shumë autorë.

Albanologu i njohur kroat, Henrik Bariqi, shkruan: *Shqiptarët janë miq të vjetër të dubrovnikasve dhe në Dubrovnik qëmoti ka pasur shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe familja Sorgo (Sorkoçeviq), e cila u pranua në aristokracinë e Dubrovnikut, sepse, sipas rrëfimeve, njëparaardhës i tyre, një shqiptar nga Rodoni, në çastin e fatkeqësisë, kishte sjellë sasi të mëdha sorgumi që e shpëtoi Dubrovnikun nga uria.*[9]

Tntelektuali i njohur kroat, Predrag Matvejeviç, duke folur për kulturat si sisteme të hapura, që pasurohen nëpërmjet ndikimeve të huaja, shkruante se kultura kroate i kishte hapur horizontet e saj për zëdhënësit e vullnetit të mirë dhe kontribuuesit e zhvillimit kulturor kroat, përkundër origjinës së tyre jokroate. Ai i përmend edhe Sorkoqeviçët (nga familje shqiptare që Dubrovnikut i shiste drith: Sorgo).

Studiuesja Zdenka Janekoviq-Romer thekson se origjina e familjes Sorgoçeviq ishte nga Shqipëria.[10]

Kronistët kanë shkruar se familja Sorgo ishte me origjinë nga Kotori, kurse origjinën e largët e kishte nga Kepi i Rodonit ose nga Epiri.

Sorgot, sipas kronikave të vjetra, kishin ardhur në Dubrovnik më 1272. Kjo nuk përputhet me të vërtetën historike, sepse Marin Vito Sorgon e hasim në Dubrovnik nga viti 1269. Për sa i përket origjinës së familjes në regjistrimin e kësaj kohe thuhet: *Di Redonid'Albania antichi.*[11]

Në një burim thuhet se familja Sorkoqeviç (Sorgo) përmendet nga viti 1253, gjegjësisht përmendet *Vita de Dobroslavo*, që kishte vdekur para vitit 1281. Kjo do të thotë se një Dobroslav ka jetuar në gjysmën e parë të shekullit XIII. Përveç kësaj, përmendet Vito që kishte një djalë të quajtur Dobrosclavus. Ai përmendet nga viti 1274 deri më 1283, kur shënohet se vdiq.[12] Sipas *Enciklopedisë kroate*[13] anëtarët e dinastisë Sorgo përmenden nga shekulli XII.[14] Kronisti nga Dubrovniku, N. Ranjini, shkruante se kjo familje ishte bërë pjesë e aristokracisë së Dubrovnikut pasi një paraardhës e ndihmoi qytetin në kohën e urisë së madhe, duke sjellë gjëra ushqimore, veçmas sorgum.[15]

Anëtari më i vjetër i familjes ishte Dobrosclaua (i lindur rreth vitit 1160). I pari që përmendet nëpër burime të ndryshme është djali i tij Vido (Vita). Ai më 1253 ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Dubrovnikut dhe kishte qenë pjesëmarrës në arritjen e aleancës për këmbime tregtare ndërmjet Dubrovnikut dhe carit bullgar Mihael I. Asenit.

Në enciklopedi, mes të tjerash, thuhet se Vido kishte shtatë fëmijë, nga më i vjetri Marini (rreth 1220-rreth 1282), me pseudonimin Pesta (Peshtiq), deri tek më i riu Nikola (i lindur rreth 1245). Në shekujt XIV dhe XV përmendet Stjepan Marini (rreth 1320-1388).

Sorgot ishin familje me ndikim të madh në jetën politike të Dubrovnikut, veçanërisht në planin e brendshëm. U dallua Gaudenci Nikolino (rreth 1562-1616), i quajtur edhe Debo.

Enciklopedia jep të dhëna edhe për degëzimet e familjes Sorgo, gjegjësisht lidhjen me familjen Puçiq-Sorkoçeviq (Pozza-Sorgo). Këtij degëzimi i përket Jelena Ranjina (Elena Ragnina; rreth 1784-1865), një grua erudite, e cila konsiderohet kompozitorja e parë kroate.

Pjesë e kësaj familjeje ishte diplomati Marin Orsatov (1692-1761). Djali i tij, Antun Vlaho (1727-1810), kishte shkruar këngë në gjuhën italiane, kurse djali tjetër, Orsati (i lindur më 1719), ishte rektor i rendit jezuit në Dubrovnik. Nga kjo familje ishin edhe poetët Luko Didak dhe Ivan Gunduliq.

Fisit Sorgo i përkasin edhe Valoviqët dhe Sorgo – Bobali. Të parët rrjedhin nga Vicki (rreth 1535-1589), djali i të cilit, Valentin Sorgo Valoviq (rreth 1565-1604), ishte poet. Nga degëzimi tjetër me mbiemrin Sorgo – Bobali rrjedh Miha (rreth 1530-1613), me pseudonimin Balabanoviq. Nipi i tij, Miho Ivanov, (i lindur rreth vitit 1625), ishte shkrimtar dhe diplomat në Republikën e Venedikut.

Degëzimi familjar

Sorgo – Bobali u shua në shekullin

# shqiptare e Dubrovnikut



XVIII me vdekjen e arqipeshkvit Fran (1721-1800).

Nga një degë e familjes Sorgo, në shekullin 18, u shquan: kompozitori dhe diplomati Luka Sorgo, djali i tij, kompozitori dhe diplomati Antuni, vëllai i tij, poeti Miho dhe motra, poetja Kata.

Luka Sorgo me fëmijët Marinin dhe Antunin u shquan edhe si kompozitorë. Veprat muzikore të Marinit kanë humbur.

Origjinën e kësaj familje kanë dashur ta përvetësojnë serbët, duke i paraqitur si "serbë katolikë", por kjo tendencë është hedhur poshtë nga studiuesit.

Për origjinën e emrit Sorgo studiuesit pajtohen se lidhet me bimën e sorghumit, sikurse e thotë edhe kronisti i moçëm nga Dubrovniku, N. Ranjini.[16]

Emri i familjes në burimet sllave shënohej si Sorgocevic apo Sorkocevic, kurse në burimet latine shënohej si Sorgo c dhe Sorkoc. Nga gjysma e dytë e shekullit XIV shënohet vetëm Sorgo.

## Personalitete nga familja Sorgo

Familja Sorgo dha shumë emra të njohur, veçanërisht kompozitorët Luka Sorgo, i biri Antuni dhe Elena Pozzo Sorgo.

Luka Sorgo (1734-1789) është kompozitor i njohur i shekullit 18 dhe konsiderohet autor i simfonisë së parë në Dubrovnik. Djali i tij Antuani (1775-1841) ishte kompozitor dhe diplomat, i vëllai Miho Sorgo (1739- 1896) ishte poet, ashtu sikurse edhe motra Kata (1729-1792).

Vëllezërit Luka dhe Miho Sorgo ndikuan në jetën shoqërore dhe politike të Dubrovnikut të shekullit 18. Dy vëllezërit ishin të lidhur edhe me oborrin e dinastisë Habsburge. Pavarësisht prej angazhimit të tyre politik, Dubrovniku nuk arriti të ripërtërihej në aspektin demografik dhe ekonomik si pasojë e tërmetit katastrofal të vitit 1667.[17] Në vitin 1783 ata ndikuan në politikat reformuese të Republikës së Dubrovnikut. Ishte koha kur borgjezët kishin frikë nga ndryshimet dhe vepronin sipas logjikës: Më mirë të çmojmë traditat e vjetra se sa të zbatojmë të rejat, sikurse shkruan Luka Sorgo në ditarin e vet.[18]

Si kompozitor Luka Sorgo ishte adhurues i artit muzikor italian të periudhës para klasike dhe la disa vepra shumë të çmuara muzikore.

Në ditarin e vet ai flet për takimet me personalitete të njohura të kohës dhe për vizitat në Paris, ku ai *kishte njohur kompozitorë të shquar evropianë*. Mbajti lidhje me Fortisin, Haydnin, Gluckin, Bajamontin.

Trashëgimtarë të Lukas janë: Antuni, Katarina (që u shpërngul në Ankonë); Elena (e martuar me Nikola Sorgon i quajtur Debo), Magdalena dhe Mariana (e martuar me Raf Gozzen).

Luka Sorgo, i sëmurë nga melankolia, i dha fund jetës duke u hedhur nga dritarja e shtëpisë së vet.[19]

Miho Sorgo (1739-1796) u afirmua si poet. Ai studioi në Bolonjë, nën mentorimin e profesorit të famshëm të filozofisë dhe retorikës Zannotit, një përfaqësues i enciklopedizmit të shekullit 18. Në vitet 1776 dhe 1777 qëndroi në Venedik në një mision shtetëror. Gjatë vizitave në qytete italiane ai u miqësua me shumë shkrimtarë e shkencëtarë të njohur. E kishte mik teologun dhe udhëpërshkruesin italian Alberto Fortisin (1741-1803); Melchiore Cesarottin (1730-1808), përkthyesin e Homerit dhe Ossianit në gjuhën italiane; me Elisabett Turrin (1751- 1796), që kishte përkthyer nga gjermanishtja në italisht Gessnerin dhe Lesingun; me Marmonelan (1723-1799), Leopold Caldanin, kryetarin e parë të Accademia delle scienze (1778) të Padovës, Isabella Teotochi Marin – Albrizzin, shkrimtarin Stefan Arteaga (1747-1799), poetin e njohur klasicist Vincenz Monti (1754-1828) etj.

Miho kishte krijuar në shtëpinë e vet edhe një Akademi, e cila u shua më 1793. Ai kishte treguar interesim për poezinë popullore, për gjuhën, historinë dhe traditat sllave.

Antun Sorgo (Antun ose Antonio Sorgo, 1775-1841[20]) ishte i biri i Lukës. U dallua si kompozitor, shkrimtar dhe diplomat. Kontribuoi në historinë politike, në gjuhësi dhe etnografi. Ishte emisari i fundit i Republikës së Raguzës në Paris. Nga viti 1794 ishte anëtar i Kuvendit të Dubrovnikut. Antun Sorgo u shkollua në Kolegjin e Raguzës dhe më pas *studio në Romë*, ku i ishte besuar familjes së Benedikt Stayt. Nga viti 1806 e udhëhoqi Ambasadën e Raguzës në Paris. Si diplomat ishte ithtar i krijimit të një krahine të Dubrovnikut, që së bashku me Ishullin e Kotorit do të ishin pjesë e Austrisë. Puna e tij krijuese u përmblodh në librin *Fragmente nga historia politike dhe letrare e Republikës së vjetër të Dubrovnikut dhe mbi gjuhën sllave*. Ai krijoi pesë simfoni dhe disa vepra të tjera muzikore. Gjatë qëndrimeve në Itali lidhi miqësi me shumë poetë të njohur italianë.[21] Antuni u bë pjesë e Këshillit të Lartë të Dubrovnikut në vitin 1794. Më 1800 e gjejmë në Venedik, kurse më 1805 shpërngulet në Paris ku, si frankofil i theksuar, merret me misione diplomatike për Republikën e Raguzës. Pas Kongresit të Vjenës shkroi pjesë letrare, studime për gjuhën dhe historinë politike, që u botuan si libër më 1839, në Paris. Duket se veprimtaria letrare dhe diplomatike ishin më të rëndësishme për të sesa ajo muzikore.[22] Ai ka merita për hapjen e Katedrës së Sllavistikës në Sorbonë, ndonëse ai bototne vetëm në gjuhën franceze dhe italiane, sikurse i shkruante edhe korrespondencat private. U angazhua edhe për projektin e akademisë ilire në Lubjanë dhe në Dubrovnik.

Antuni, deri në fund të jetës, mbeti mik me Prosper Merimenë.

Së bashku me Tomo Basseglin gëzuan përkrahje nga borgjezia, e cila i çmonte idetë letrare dhe filozofike të iluminizmit, por jo edhe veprimet e jakobinëve.

Kata Sorgo (1729-1792) ishte një grua erudite, e martuar me Jakobic Basseglin. Ajo ishte e motra e kompozitorit Luka dhe eruditit Miho. Motra tjetër quhej Maria, e martuar me Fran Ragninin, konsullin e Dubrovnikut në Petrograd. Kata përmendet për prirjet letrare, gjuhët e huaja, për matematikë, politikë dhe ekonomi. E bija Desha (1759-1804) ishte shkolluar në Itali, ashtu sikurse djali i saj, eruditi Tomo Bassegli (1756-1806).

Toma Bassegli (ose Toma Basiljeviq, 1756-1806) ishte intelektual me prirje filo-franceze dhe filo-austriake. Njihet me mbiemrat: Bazilic, de Basilio, Bassegli. Kjo familje është me origjinë nga Kotori, kurse në Dubrovnik përmendet nga shekulli XIV. Ai ishte një nga iluministët më të njohur kroat. Kreu funksione të ndryshme në Republikën e Dubrovnikut. Ishte shkrimtar, eseist, filozof dhe shquhej për qasjet liberale. Toma Bassegli ishte shkolluar në disa universitete evropiane dhe ishte njohës i letërsisë evropiane Adhuronte Shakespearein, Joseph Addisonin, James Thomsonin, Edward Youngun, Alexander Popen, Laurence Sternen, Francis Baconin, Thomas Hobbesin etj. Njihet për angazhimin për ta reformuar Republikën e Dubrovnikut. Qasjet e tij i shprehu në librin Le plan de reforme de la constitution de la Republique de Raguse, ku parasheh reforma pa revolucion. Ai mendonte se Dubrovniku duhej të bëhej qendër e një republike ilire, e cila do t 'i përfshinte të gjithë sllavët e jugut.

Elena Pozza Sorgo (1786-1865) përmendet si intelektuale dhe si kompozitore e njohur. Ajo njihet me emrat Elena Luisa Pozza Sorgo, Elena Luisa Ragnina, Elena Puçiq Sorgoçeviq. Konsiderohet si kompozitorja e parë kroate. Ka shkruar poezi dhe njihej si pianiste e shkathtë. Në koleksionet e Dubrovnikut ruhen 30 pjesë muzikore të autorëve të Evropës Qendrore që ishin pronë e saj.[23]

## Miqësitë e Sorgove

Familja Sorgo ishte mecenë e shumë poetëve, piktorëve, shkencëtarëve e dijetarëve. Është e njohur vila e Sorgove, ku piktura artistësh të njohur evropianë i stolisin muret e saj. Aty zhvilloheshin takime me intelektualë e diplomatë të ndryshëm. Nën përkujdesjen e familjes ishte shkencëtari Rugjer Boshkoviqi (1711-1787). Pas vdekjes së shkencëtarit familja u përkujdes edhe për të ëmën dhe motrën, Anicën (1714-1803).

Luka Sorgo i kishte kërkuar poetit Rajmund Kuniq (1719-1794) që të shkruante elegji për shkencëtarin por, poeti, në epigramin Ad Lucam *Antonii de Sorgo rogantem, ut in Rogerii Boscovichii parentalibus aliquid scriberet*, thotë se nuk e shkruante dot për shkak të tronditjes që kishte përjetuar nga kjo vdekje. Miq të përhershëm të familjes Sorgo, në këtë kohë, ishin latinistët Frano Stay, Bernard Zamagna (1735-1820), Gjuro Feriq (1739-1820) dhe mjeku Gjuro Hixha (1752-1833).[24]

Luka Sorgo kishte miqësi me poetin dhe libretistin italian Pietro Metastasio (1698-1782). Në ditarin e tij shkruante se ai ishte poeti i shekullit dhe një njeri i jashtëzakonshëm për mirësinë e tij.

Për Antun Sorgon kanë shkruar shumë poetë. Poeti Junije Resti, i magjepsur nga mënyra se si Antuni luante me kitarë, i kushtoi disa poezi atij, por edhe anëtarëve të tjerë të familjes Sorgo. Veçohet elegjia për Miho Sorgon dhe satira Musica, kushtuar Antunit. Poeti Marc Bruere[25] i kushtoi pesë poezi Antunit, kurse poeti nga Dubrovniku, Faustin Galjuf (1765-1834), ia kushtoi librin Navis ragusina.

Antuni kishte korrespondenca me personalitete të shquara nga Evropa, veçmas nga fusha e diplomacisë dhe e artit. Janë të njohura edhe korrespondencat e tij me Madame de Stael (1766-1817).

Poetët e kohës i kishin kushtuar disa poezi edhe Marina Sorgos, veçmas poeti Marc Bruere.[26] Ajo shquhej për ekzekutim në harpë.

## Përfundim

Familja Sorgo dha emra të shquar në politikë, diplomaci, ekonomi, art, veçanërisht në muzikë. Shkëlqimi i saj u shua së bashku me shuarjen e Republikës së Dubrovnikut. Për pjesëtarët e kësaj familje janë shkruar studime dhe krijime artistike. Familja gëzonte respekt në qarqe diplomatike e kulturore evropiane. Sipas të dhënave që kemi, pa pretenduar se janë të plota, kjo familje nuk i ruajti lidhjet me botën kulturore shqiptare. Studimet më të thelluara, mbase, do të zbulojnë të dhëna me interes jo vetëm për Sorgot, por edhe për lidhjet eventuale të tyre me botën arbërore. Për këtë shkak duhen bërë sa më shumë gjurmime nëpër arkiva, veçanërisht në Dubrovnik. / *Telegrafi*

[1] Sipas disa studiuesve, viti është 1284, por te shumica e autorëve viti i kësaj dëshmie është 1825 (Jireçek, Elsie, Geofrrey, Matasoviq, Kapor etj.). Elsie shkruan kështu: Rasti më i hershëm, i vitit 1285, i takon jo Shqipërisë vetë, por krahinës së Dubrovnikut ose të Ragupës, ku jetonin mjft shqiptarë. Në hetimet për një vjedhje në shtëpinë e Petro de Volcio nga Belena, njëfarë Matheus, biri i Markut prej Mençe, i cili ishte, siç duket, dëshmitar i krimit, raportoi kështu Idinisht: 'Audivi unam vocem clamantem in monte in linguaalbanesca' (Dëgjova një%ë duke thirrurnë mal në gjuhën albaneske).

[2] Nicholas Geoffrey, Lempriere Hammond (1976), Migrations and invasions in Greece and adjacent areas. Noyes Press, str. 57. ISBN 978-0-8155-5047-1.

[3] Të dhënat e para i jep shkrimtari i njohur raguzian Serafia Maria Çerva në veprën Bibliotheca Ragusina, in qua Ragusini scriptores eorumque gesta et scripta recensentur, ku shqyrtohen shkrimtarët raguzinë, si dhe veprat dhe shkrimet e tyre, shkruar rreth viteve 1740-1742, në katër vëllime. Dorëshkrimi ruhet në Bibliotekën e Manastirit domenikan të Dubrovnikut.

[4] Nenad Vekaric, Vlastela grada Dubrovnika, Korijeni struktura i raqvoj dubrovackog plemstva, sv. 1., Zabod qa povijesne qnanostiHAZU u Dubrovniku, Zagreb-Dubrovnik, 2011, f. 249-276

[5] Jahja Drançolli, Historia e hershme e dominikanëve arbërorë, 800-vjetori i Urdhrit Dominikan: http://www.drita.info/2016/01/26/historia-e-hershme-e-dominikaneve-arberore-i/

[6] Edit Durham, Zakoni i oticai medu plemena u Balkanu, 1928, f. 34-38

[7] Mikel Prennushi, Arqipeshkvi Pal Engjëlli (1417-1470), humanist i shquar shqiptar dhe bashkëpunëtor i afërt i Skënderbeut, http://www.arbitalia.it/cultura/interventi/pal_engjelli.htm

[8] Kocra Kocthh, PpzoBC-m ifenmpu u dpyMOBe, BeorpagcKe OnmiHHCKe

[9] H. Bariç, BusanmuncKO nopeKAO KyAma lammumnuKa PyëpoBHUKa, Vreme, 2. 2. 1941, f. 14

[10] Zdenka Janekoviq-Romer, Okvir slobode, Dubrovacka vlastela izmegu srednovekovlja i humanizma, Zavod za povijesne znanosti Hrvatske akademije znanosti i umjetnosti u Dubrovniku, Zagreb – Dubrovnik, 1999, f. 37. Shih edhe CppaeucmuuKa Bpujedmcm neuama, Cpn, 15. 2. 1907, f. 131, ku, mes të tjerash, thuhet: Sorgo, një familje kompoyitorësh që erdhi ngaShqipëria

[11] Milorad Medini, StarineDubrovacke, Jadran, 1935, f. 97

[12] Recueil de travaux de l'institut d'etudes byzantines. Institut, 1966

[13] Enciklopedija.hr

[14] Irmgard Manken, Dubrovacki patrijarkat u XIV veku, Naucno delo, Beograd, 1960, f. 407

[15] Sorgum, sorgo = melekuqe, një lloj drithi

[16] Z. J. Romer, ibid, f. 184

[17] Slavica Stojan, Kulturni krug Luke i Miha Sorga (Sorgocevica): Glazbenici, pjesnici i diplomati, Anali Dubrovnik 54/2, 2016, f. 247

[18] Ibid, f. 249

[19] Shih Hrvatski biografski leksikon, i botuar në Zagreb më 1983

[20] Sipas një studimi, data e vdekjes së tij është 1836 (Cpu, 31. 12. 1906, f. 782)

[21] Slavica Stojan, Kulturni krug Luke i Miha Sorga (Sorgocevica): Glazbenici, pjesnici i diplomati, Anali Dubrovnik 54/2, 2016, f. 247-262

[22] Ibid, f. 257

[23] Vjera Kataliniq, Elena Pucic Sorgocevic, Arti musical, 2006, f. 67-78

[24] Slavica Stojan, Kulturni krug Luke i Miha Sorga (Sorgocevica): Gla%benici, pjesnici i diplomati, Anali Dubrovnik 54/2, 2016, f. 251-252

[25] Marc Bruere (kroatisht: Marko Bruerovic 1770-1823), shkrimtar dhe dramaturg nga Dubrovniku me origjinë franceze.

[26] Slavica Stojan, op. cit. f. 250-256




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Drenica e motivuar kërkon pikë edhe ndaj Llapit

Portieri Arion Ymeri ka thënë se, pas rezultateve të mira në pesë xhirot e fundit, Drenica kërkon rezultat të favorshëm edhe në ndeshjen ndaj Llapit e cila zhvillohet sot (e premte) nga ora 13:00. Në anën tjetër, Labinot Osmani ka paralajmëruar se tri pikët e plota do të mbesin në "Zahir Pajaziti". Tri ndeshjet e tjera zhvillohen nesër (e shtunë) dhe dy ndeshjet e fundit zhvillohen pasnesër (e diel)

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 31 tetor** - Skuadra e Drenicës ka hyrë në një seri të rezultateve pozitive dhe këtë seri po synon ta vazhdojë edhe në ndeshjen ndaj Llapit e cila zhvillohet sot (e premte) nga ora 13:00 në stadiumin "Zahir Pajaziti". Portieri Arion Ymeri ka thënë të enjten për "Epokën e re" se skuadra kuqezi nga Skenderaj është shumë e motivuar që të marrë rezultat pozitiv edhe në ndeshjen e radhës, pasi në pesë ndeshjet e fundit nuk ka pësuar asnjë humbje, madje ka pranuar vetëm një. "Jemi në një seri të rezultateve pozitive. Në pesë ndeshjet e fundit jemi pa humbje. Shkojmë në Podujevë, në një terren mjaft të vështirë, që të marrim rezultat pozitiv dhe të mos e ndërpresim këtë seri të suksesshme. Motivi është shumë i lartë, sepse kemi pranuar vetëm një gol dhe besojmë se mund t'ia arrijmë synimit", ka thënë Ymeri, i cili ka konfirmuar se Tahir Lushtaku i ka të gjithë futbollistët në dispozicion për këtë ndeshje. "Jemi të kompletuar për këtë ndeshje. Llapi është në presion më të madh se ne, sepse në xhirot e fundit nuk ka arritur rezultate pozitive. Do të jetë një ndeshje e vështirë për të dyja klubet dhe shpresojmë që do t'ia dalim me sukses", ka shtuar ai.



Ndërsa skuadra e Llapit nuk po tregon stabilitet për arritjen e rezultateve pozitive, pasi nga pesë ndeshjet e fundit ka regjistruar dy fitore dhe tri humbje. Futbollisti me përvojë të madhe në këtë klub, Labinot Osmani, ka thënë për gazetë se synim i skuadrës nga Podujeva është rikthimi te fitoret. "Ne do ta japim maksimumin në këtë ndeshje për fitore dhe për rikthimin e rezultateve. Ne nuk mendojmë për hakmarrje për humbjen në ndeshjen e parë, por do të përqendrohem që t'i arkëtojmë tri pikë të plota. Mungesë të vetme në këtë ndeshje, për shkak të kartonëve, e kemi Benjamin Eminin", ka deklaruar Osmani.

Skuadra e Llapit ka kërkuar mbështetje para ndeshjes me Drenicën në mënyrë që të këndellet pas dy humbjeve radhazi në elitë. "Skuadra është duke punuar maksimalisht për duelin e fundjavës, ku synohet këndellja pas dy humbjeve radhazi, të cilat janë mësim për ndeshjet e ardhshme e që duhen harruar sa më parë, teksa në këto çaste jo të mira rezultatesh na duhet mbështetje e parezervë e të gjithëve që t'i vazhdojmë ndeshjet e tjera me ecuri pozitive", thuhet në njoftimin e Llapit. Aktualisht skuadra e Llapit është e pesta në renditjen tabelore me 20 pikë, kurse Drenica renditet dy pozita më poshtë me 17 pikë.

**IPKO SUPERLIGA - Java e 13**

**Të premten takohen:**
13:00 Llapi - Drenica

**Të shtunën takohen:**
13:00 Trepça '89 - Vushtrria
13:00 Feronikeli - Ballkani
13:00 Dukagjini - Prishtina

**Të dielën takohen:**
13:00 Gjilani - Ferizaj
13:00 Flamurtari - Drita

## SHKURT

### Agim Ademi kërkon nga gjyqtarët të jenë më profesionalë

Kryetari i Federatës së Futbollit i Kosovës, Agim Ademi dhe kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, kanë mbajtur sot një takim me gjyqtarët e Superligës dhe Ligës së Parë. Gjatë këtij takimi presidenti Ademi ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur javë më parë në Gjilan për sulmin fizik ndaj gjyqtarit anësor Meriton Berisha. Ai ka thënë se janë duke u hulumtuar nga organet e FFK-së të gjitha ato që kanë ndodhur deri më tash. "Ademi ka kërkuar nga të gjithë gjyqtarët të jenë shumë më vigjilentë dhe më profesionalë në punën e tyre në fushën e gjelbër. Ai ka theksuar se nuk do të tolerohen gabimet dhe tendencat ngaqë investimet e klubeve janë rritur dhe ato duhen mbrojtur me drejtësi maksimale në fushën e gjelbër. Gjithashtu, presidenti Ademi kërkoi nga gjyqtarët të jenë sa më të koordinuar, të mos bëjnë gabime dhe ta ruajnë rregullsinë e ndeshjeve, ngaqë puna e gjithsecilit prej tyre është me përgjegjësi të madhe", thuhet në njoftimin e FFK-së.

### Vukiqeviqi: Rroga ime nuk ishte 8 000 euro

Trajneri Dejan Vukiqeviq është larguar dje nga skuadra e Feronikelit. Tekniku malazez ka folur për herë të parë qëkur ndau rrugët me kampionët e e Kosovës. Vukiqeviqi foli për mediumin malazez "vijesti.me" derisa theksoi se marrëveshja është shkëputur në mënyrë të njëanshme dhe se paga e tij mujore nuk ishte ashtu siç ishte raportuar në mediet e Kosovës (8 mijë euro në muaj). "Unë nuk kam ofruar dorëheqje time, por klubi e ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme kontratën dhe për këtë kemi ende për të biseduar. Gjithashtu, dua t'ju tregoj se informacionet në lidhje me pagën time mujore janë totalisht të pavërteta", ka deklaruar Vukiqeviqi.

### Xhaka duhet të mbetet kapiten sipas lojtarëve të Arsenalit

Lojtarët e Arsenalit e mbështesin Granit Xhakën për ta mbetur kapiten pavarësisht përplasjes që ka pasur me tifozët e klubit. Portieri Emiliano Martinez ka thënë se në zhveshtore të gjithë janë përkrah Xhakës pas reagimit që ai pati me tifozët të dielën në barazimin 2 me 2 me Crystal Palacen në Premierë Ligë. Sipas trajnerit Unay Emery, Xhaka është i shkatërruar me rastin, por ai ka përkrahjen e të gjithëve për t'i kthyer raportet e mira me tifozët. "Trajneri vendos nëse ai do të jetë kapiten ose jo. Por për ne si grup, si lider, e përkrahim", ka thënë Martinez. "Ai është i dashur, është pak i shkatërruar sepse ka familje të mirë, zemër të mirë dhe e do klubin. Kur dikush kalon nëpër këtë fazë, ne duhet ta përkrahim dhe jemi bashkë. Donim të fitonim ndeshjen për të", ka shtuar Martinezi.

## FFK-ja publikon çmimet e biletave për ndeshjen Kosovë - Angli

**Prishtinë, 31 tetor** - Më 17 nëntor në stadiumin "Fadil Vokrri" do të luhet ndeshja në mes të Kosovës dhe Anglisë. Kjo ndeshje ka rëndësi të madhe për 'dardanët', sidomos pas rezultatit që do të ketë Kosova në ndeshjen paraprake në Çeki. Në rast të fitores atje, një barazim në Prishtinë do ta dërgonte Kosovën në "Euro 2020". Federata e Futbollit e Kosovës ka publikuar çmimet e biletave për këtë ndeshje. Në tribunat veri dhe jug bileta do të kushtojë 5 euro, në lindje 10-15 euro, në perëndim 15-20 euro, ndërsa më të shtrenjtat do të jenë VIP, të cilat kushtojnë 80 euro. Biletat do të dalin në shitje javën tjetër.



## Klitschko: Kam ende një rekord për ta thyer



**Kiev, 31 tetor** - Boksieri ukrainas Wladimir Klitschko, në një intervistë për "Business Insider", ka bërë me dije se mund të rikthehet sërish në ring vitin e ardhshëm. Ai humbi titujt kampionë bote të peshës së rëndë në vitin 2015 kur humbi duelin me Tyson Furyn. Ndërsa sfida e tij e fundit në ring daton në vitin 2017, kur u mund nga një tjetër britanik, Anthony Joshua. Gjithsesi, ukrainasi shprehet se rikthimi në ring është një mundësi reale për të. Ai ka një objektiv të qartë: Të bëhet boksieri kampion bote më i vjetër në moshë në peshën e rëndë. Rekordi mbahet nga George Foreman, që ishte kampion i këtij Divizioni në moshën 45-vjeçare. "Unë ende kam shanse të dueloj dhe hera-herës mendoj rikthimin. Jam vetëm 43 vjeç. Nuk do të rikthehem vetëm sa për të zhvilluar një duel. Rikthehem për të thyer një rekord. Kam qenë dy herë kampion bote. Mund të bëhem sërish i tillë edhe për herë të tretë. Foreman u bë kampion bote në moshën 45-vjeçare, ndaj mund ta realizoj edhe unë këtë gjë", ka thënë Klitschko.

# Fillojnë bisedimet për zgjerimin e stadiumit 'Fadil Vokrri'




**Prishtinë, 31 tetor** - Kanë filluar bisedimet në mes të Komunës së Prishtinës dhe Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për zgjerimin e stadiumit "Fadil Vokrri" dhe shtimit të rreth shtatë mijë ulëseve në disa prej tribunave të tij. Lajmi është konfirmuar nga kryetari i kryeqytetit, Shpend Ahmeti.

Stadiumi "Fadil Vokrri", pronë e Komunës së Prishtinës, është nikoqir i ndeshjeve të Kombëtares së Kosovës dhe ka një kapacitet prej 13 500 ulëseve, por shihet si tejet i ulët për kërkesat e kosovarëve për t'i parë ndeshjet e verdhekaltërve, prandaj ka kohë që kërkohet zgjerimi i tij. Kryetari Ahmeti ka bërë me dije se stadiumi do t'i ketë 20 mijë ulëse. Zgjerimi do të ndodhë në tribunat me kapacitetin më të ulët, pra jug, veri dhe lindje. "Komuna e Prishtinës ka filluar diskutimet me Federatën e Futbollit të Kosovës për zgjerimin e kapaciteteve në stadiumin 'Fadil Vokrri', në tribunat e lindjes, veriut dhe jugut. Gjatë javëve në vijim do t'i bëjmë analizat e nevojshme për t'i vlerësuar mundësitë që të kemi deri në 20 mijë ulëse në stadiumin e qytetit", ka shkruar Ahmeti në profilin e vet në "Facebook".

# Houstoni fiton dramën ndaj Washingtonit



**Uashington, 31 tetor** - Janë zhvilluar 11 ndeshje në NBA, por sfida që tërhoqi më shumë vëmendjen ishte ajo e "Capital One Arena" e Washingtonit, ku Wizardsi u mposhtë me vetëm një pikë diferencë, 158-159 nga Houston Rocketsi. Një përballje kjo e çmendur në kryeqytet, pasi u shënuan në total 317 pikë, 59 vetëm nga James Hardeni (Rockets) dhe 46 nga Bredley Beal (Wizards). Russell Wetbrooku regjistroi "triple-double" e dytë sezonal (17 pikë, 12 asistime dhe 10 "rebounde"), ndërsa plot 13 lojtarë nga të dyja skuadrat arritën shifra të dyfishta pikësh. Qershia mbi tortë ishte pa dyshim fitorja në "sprintin" final e skuadrës teksane me vetëm 1 pikë diferencë. Atmosfera, pak a shumë, u krijua sikur po luhej një sfidë e All Starit, ku askush nuk e kishte mendjen te mbrojtja. Thjesht për ta përmbledhur ishte një mbrëmje magjike. Vjen humbja e tretë sezonale për Golden State Warriorsin, i cili u dorëzua 110-121 përballë Phoenix Sunsit. Një disfatë që djeg dyfish, pasi finalistët e sezonit të kaluar duhet të bëjnë pa "yllin" skuadrës, Stephen Curry, për një kohë të gjatë. 31-vjeçari pësoi frakturë në dorën e majtë në periodën e tretë, duke u detyruar ta mbyllte para kohe takimin. Praktikisht, Warriorsi e humbi përballjen që në periodën e parë, që u mbyll me një rezultat të pjesshëm 14-43. Reagimi i tyre në periodën e fundit, ku rikuperuan 19 pikë, ishte i padobishëm. Në këtë sukses të Sunsi spikati veçanërisht Devin Booker me 31 pikë, i ndihmuar nga Aaron Baynes që shtoi 24 pikë të tjera dhe kontrolloi plot 13 topa nën tabelë. 125-113 triumfuan Toronto Raptors ndaj Detroit Pistonsit, në një takim ku spikati Pascal Siakam me 30 pikë, ndërsa Kyle Lowry shtoi edhe 20 pikë të tjera. Ndërsa në suksesin 116-105 të Boston Celticsit ndaj Milwaukee Bucksit më i miri mbi parket rezultoi Kemba Walker me 32 pikë.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Boston - Milwaukee | 116-105 |
| Golden State - Phoenix | 110-121 |
